




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

UDHËZUES
për **PLANIFIKIMIN HAPËSINOR**
ME PJESËMARRJE
në **KOSOVË**





USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

UDHËZUES

për **PLANIFIKIMIN HAPËSINOR**
ME PJESËMARRJE
në **KOSOVË**

Gusht 2015

CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
TRASHËGIMIA KULTUROR PA KUFJ

Udhëzuesi për planifikimin hapësinor me pjesëmarrje në Kosovë është përgaditur dhe publikuar në kuadër të projektit: Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal i cili është zbatuar nga CHwB dhe financuar nga USAID/Partneritetet për zhvillim.

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë udhëzues nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ekipi hartues dhe i publikimit:

Menaxher projekti: Dukagjin Bakija

Autor: Lumnije Gashi-Shabani

Drita Nushi - bashkautore

Rudina Qerimi - bashkautore

Kontribues: Aida Dobruna, Shkelqim Daci dhe Vllaznim Osmani

Përkthimi në gjuhën shqipe: Kaltrina Thaqi

Përkthimi në gjuhën serbe: Adrijana Hiseni

Fotografite: CHwB

Botues: Trashëgimia Kulturore pa kufij (CHwB), zyra në Kosovë

Titulli: Udhëzues për planifikimin hapësinor me pjesëmarrje në Kosovë

Financuar nga: USAID/Partneritetet për zhvillim

Dizajni, faqosja dhe printimi: ASHA

Ky publikim është përgatitur nga Trashëgimia Kulturore pa kufij (CHwB) për Chemonics International në kuadër të aktiviteteve të realizuara nën Kontraten Nr. FOG No. C2-03-2014.

“ Coming together
is the beginning.

Keeping together
is progress.

Working together...
is success.

~Henry Ford

“Bashkimi është fillimi, qëndrimi bashkë është përparim, veprimi bashkë është sukses!”

~ **Henri Ford**

Hyrje

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka miratuar Ligjin e ri mbi Planifikimin Hapësinor, (LPH) Nr 04 / L-174 në shtator të vitit 2013. Ligji promovon pjesëmarrjen e publikut si një prej parimeve të qeverisjes së mirë në formulimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor. Po ashtu, Udhëzimi administrativ për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor (UA) nr. 05/2014, përcakton kërkesat minimale për përfshirjen e publikut në proceset e planifikimit hapësinor. UA kërkon nga autoritetet e planifikimit hapësinor të informojnë qytetarët për diskutime publike nëpërmjet njoftimeve publike të botuara në tri gazeta ditore, të shpallura në TV lokale dhe publike, dhe të postuara në faqet e internetit të komunave tetë ditë para se të zhvillohen diskutimet publike.

Udhëzuesi për planifikimin hapësinor me pjesëmarrje në Kosovë ka për qëllim të mbështesë UA dhe të shkojë përtej dispozitave të tij Udhëzuesi thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor. Një proces kuptimplotë i pjesëmarrjes publike ju jep mundësi qytetarëve të shprehin kërkesat dhe interesat e tyre, vënë në pah vlerat lokale si dhe të ndikojnë në politikat e planifikimit hapësinor në komunën e tyre. Udhëzuesi ofron informacione për teknikat dhe metodologjitë e pjesëmarrjes publike si dhe këshilla praktike për zbatimin e tyre.

Në mënyrë që të rritet pjesëmarrja dhe për të iu qasur të gjitha grupeve të komunitetit, ky udhëzues ka për qëllim të ofrojë informacion shtesë mbi teknikat e pjesëmarrjes publike përtej atyre që kërkohen nga UA nr. 05/2014.

Jo të gjithë qytetarët kanë luksin për të blerë gazetën, dhe jo të gjithë prej tyre kanë qasje në TV dhe internet. Përvojat deri më tani kanë treguar se shumë shpesh, grupe të caktuara të njerëzve, siç janë familjet me të ardhura më të ulëta, të moshuarit, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, komunitetet jo shumicë nuk kanë qasje në këtë informacion dhe rrjedhimisht përfaqësi i tyre në diskutimet publike apo aktivitete pjesëmarrëse gjatë procesit të planifikimit mungon. Ky udhëzues ofron sugjerime konkrete se si të arrijnë të gjithë përfaqësuesit e komunitetit të mund të jenë të përfshirë në vendimet e planifikimit të cilat ndikojnë në jetën e tyre.

Me planifikim të duhur, duke siguruar qasje në takime dhe duke ndihmuar qytetarët të kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes, është e mundur që të ketë takime të suksesshme dhe produktive që ndihmojnë qytetarët të kontribuojnë në vendimet e marra në planifikim dhe të sigurojë autoritetet e planifikimit me informatat e nevojshme në lidhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Ky udhëzues ofron këshilla se si të tejkalohen pengesat për pjesëmarrje dhe për të krijuar një bashkëpunim kuptimplotë ndërmjet qytetarëve, qeverisë dhe palëve tjera të interesit.

Udhëzuesi përmban pjesën teorike ku janë përshkruar koncepti dhe rëndësia e pjesëmarrjes së publikut në planifikim hapësinor, janë dhënë parimet e pjesëmarrjes sipas praktikave ndërkombëtare dhe plani i pjesëmarrjes së publikut i elaboruar në faza. Të gjitha këto janë të ilustruara me këshillat praktike, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet që rrjedhin nga aktivitetet dhe detyrat që janë ndërmarrë në Planet për pjesëmarrjen e publikut (PPP) të zhvilluara në kuadër të projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”, i cili është zbatuar nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) dhe financuar nga USAID/Partneritetet për zhvillim gjatë periudhës janar-korrik të vitit 2015 në pesë komuna të Kosovës: Prishtina, Vushtrria, Malisheva, Gjakova dhe Peja.

Përmbajtja

Hyrje	4
Shkurtesat	5
Qëllimi i udhëzuesit	8

Kapitulli I: Pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit9

1.1. Pse është rëndësishme pjesëmarrja e publikut në proceset e planifikimit hapësinor?.....	10
1.2. Pse është rëndësishme pjesëmarrja e publikut në proceset e planifikimit hapësinor?.....	11
1.3. Kush e udhëheq procesin e pjesëmarrjes së publikut në planifikim hapësinor?	12
1.4. Kur realizohet pjesëmarrja e publikut në planifikim hapësinor?.....	13

Kapitulli II: Parimet e pjesëmarrjes së publikut në proceset e planifikimit..... 15

2.1. Gjithë përfshirja.....	16
2.2. Transparenca dhe informimi.....	18
2.3. Qasshmëria	19
2.4. Llogaridhënia	22
2.5. Barazia dhe llojllojshmëria	23
2.6. Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria.....	24

Kapitulli III: Plani për pjesëmarrjen e publikut në proceset e planifikimit hapësinor në nivel lokal 25

3.1. Hapi 1: Përgatitjet për pjesëmarrjen e publikut në aktivitetet e planifikimit	26
3.1.1. Organizimin e punës	26
3.1.2. Ndërtimi i partneriteteve.....	26
3.2. Hapi 2: Identifikimi i palëve të interesit	28
3.3. Hapi 3: Themelimi i Grupit Këshillëdhënës të Komunitetit.....	29
3.4. Hapi 4: Hartimi i planit të veprimit për pjesëmarrjen e publikut (PPP) gjatë proceseve të planifikimit hapësinor	31
3.5. Hapi 5: Zbatimi i Planit të Pjesëmarrjes së Publikut	34
3.5.1. Nivelet dhe teknikat e pjesëmarrjes publike	34
3.5.1.1. Informimi.....	36
3.5.1.2. Konsultimi	40
3.5.1.3. Dialogu	49
3.5.1.4. Partneriteti dhe fuqizimi.....	50
3.6. Hapi 6: Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të PPP në aktivitetet e planifikimit hapësinor.....	53

Kapitulli IV: Komunikimi dhe kthimi i përgjigjeve tek publiku 61

4.1 Komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë lokale	62
4.2 Rregullat bazë për trajtimin e procesit efektiv të komunikimit.....	64
4.3. Aftësitë e komunikimit dhe lehtësimit (fasilimitit).....	66
Në vend të përfundimit.....	71

ANEKSI 1: QASJA NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE NË AKTIVITITETET E PJESËMARRJES PUBLIKE.....	72
ANEKSI 2: PYETËSORËT	74
ANEKSI 3: INTERVISTIMI.....	80
ANEKSI 4: FOKUS GRUPET	83
ANEKSI 5: FORMULAR VLERËSIMI	86
Referencat:.....	88

Shkurtesat

PPP	Plani për pjesëmarrjen e publikut
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
HZK	Harta Zonale e Komunës
PRrH	Plani Rregullues i Hollësishëm
KVRL	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
CHwB	Cultural Heritage Without Borders
USAID	United States Agency for International Development
GKK	Grupi Këshillëdhënës i Komunitetit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
LPH	Ligji për Planifikim Hapësinor
UA	Udhëzim Administrativ
UA nr 05 / 2014- UA	për “përgjegjësitë e autoriteteve Planifikim Hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor”.

Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi për planifikim hapësinor me pjesëmarrje në Kosovës mëton të promovojë procesin e pjesëmarrjes publike dhe ndihmojë vendim-marrësit, planerët e komunës, profesionistët e fushës dhe komunitetin në të kuptuarit, planifikimin dhe udhëheqjen e pjesëmarrjes publike gjatë proceseve të planifikimit hapësinor. Udhëzuesi ofron një kornizë për udhëheqjen e një procesi për përfshirje efektive të publikut në planifikim sipas nevojave lokale.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të ndihmojë qytetarët dhe qeveritë lokale në mënyrë praktike për një bashkëpunim kuptimplotë të tejkalojnë sfidat në planifikim dhe të gjejnë zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët, duke mundësuar marrjen më të mirë të vendimeve dhe të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjitha komunitetet. Ky udhëzues ofron edhe rekomandime për praktikën më të mirë në mënyrë që të ndihmojë të planifikohet një proces kuptimplotë dhe efektiv i pjesëmarrjes së publikut dhe gjithashtu përmban shumë forma/formularë, shembuj dhe anekse të cilët mund të ndihmojnë zyrtarët komunal në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të pjesëmarrjes së publikut.

Angazhimi kuptimplotë e publikut në proceset e planifikimit hapësinor rrit vetëdijen e qytetarëve në lidhje me përfitimet e pjesëmarrjes së tyre në këto aktivitete. Pjesëmarrja aktive u mundëson atyre që të fitojnë njohuri në lidhje me planifikimin hapësinor, të rrit vetëbesimin e tyre dhe aftësitë e tyre për bashkëpunim duke u bërë kontribuues të vlefshëm në proces. Kjo përforcon ndjenjën e pronësisë në lidhje me planin dhe për këtë arsye lehtëson zbatimin e tij.

Kapitulli I:

Pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit

Planifikimi me pjesëmarrje është një paradigmë e planifikimit hapësinor që thekson përfshirjen e tërë komunitetit, sektorit publik dhe privat, në gjithë procesin strategjik të planifikimit hapësinor. Rëndësia e pjesëmarrjes publike më së miri ilustron nga Henry Ford me një thënie: “Bashkimi është fillimi, qëndrimi bashkë është përparim, veprimi bashkë është sukses!”.

Pjesëmarrja e publikut në aktivitetet e planifikimit hapësinor ka efekt të dyfishtë: ndikon në rezultatet e procesit dhe vetëdijesimin e publikut për të drejtën për pjesëmarrje dhe përfitimet që rezultojnë nga ky angazhim.

Pjesëmarrja efektive e publikut është edhe funksionale për planifikimin dhe kuptimplotë për publikun. Pjesëmarrja është funksionale, kur ajo ndihmon për të krijuar vendime më të mira dhe të realizueshme dhe një plan më me vlerë për komunitetin. Pjesëmarrja është kuptimplotë kur publiku ka mundësi për të ndikuar në vendime dhe krijuar një ndjenjë të bashkautorësisë për planin hapësinor.

1.1. Pse është rëndësishme pjesëmarrja e publikut në proceset e planifikimit hapësinor?

Përderisa koncepti i një “vendi demokratik” i referohet formave të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe përfaqësimit në sferën politike, të drejtat specifike, detyrat dhe obligimet e shtetasve dhe shtetit, të dyja tanimë janë mishëruar në demokracinë kushtetuese të Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës vendos një detyrim për qeverinë lokale dhe qendrore për të parashikuar zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (neni 22), Kushtetuta e Kosovës.

Përderisa ka shumë ligje të Kosovës të cilat kërkojnë disa forma të pjesëmarrjes publike për nevojat e planifikimit hapësinor kjo rregullohet përmes Ligjit për Planifikim Hapësinor (LPH) nr. 04 / L-174 (neni 20), dhe UA Nr.05 / 2014 mbi “Përgjegjësitë e Autoriteteve në Planifikim Hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimi hapësinor”.

Sipas LPH dhe UA, autoriteti i planifikimit hapësinor ofron dhe inkurajon pjesëmarrjen transparente publike në planifikim dhe procesin e vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike në të dhënat, hartat, grafikonet dhe të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor për palët e interesuara. Duhet të ndermirret një fushatë informuese për të siguruar dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e publikut gjatë fazave të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, si dhe duhet të merren parasysh dhe të merren në konsideratë grupet e cenueshme. Autoritetet e planifikimit duhet të sigurohen që të përfshijnë vlerësime publike mbi ndikimet e mundshme sociale, ekonomike dhe mjedisore, duke shqyrtuar dhe përgjigjur peticioneve nga pronarët për ndryshimin e klasifikimit të përdorimit të tokës dhe të sigurohen që afatet për pjesëmarrjen e publikut janë të mjaftueshme dhe efektive pa shkaktuar vonesa të panevojshme.

Sa i përket UA Nr.05 / 2014, gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor duhet të organizohen diskutime publike dhe forma tjera të pjesëmarrjes publike, si dhe prezantime për definimin e vizionit, objektivave, prioriteteve strategjike dhe çështjeve të tjera. Kërkesa minimale për pjesëmarrjen e publikut është që të sigurojë të paktën një diskutim publik për çdo fazë të procesit të planifikimit.

Sa i përket Nr.05 UA / 2014, në fazën e mëvonshme e planifikimit, para finalizimit të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor do të i nënshtrohen shqyrtimit publik, i cili duhet të mbahet në përputhje me parimet e përcaktuara për organizimin e prezantimeve publike dhe pjesëmarrjen. Shqyrtim publik në një draft-dokument të planifikimit hapësinor është të paktën 30 ditë; ndërsa shqyrtimi publik mbi ndryshimet e drafteve merr të paktën 15 ditë por jo më shumë se 30 ditë.

Të gjitha vërejtjet, propozimet dhe peticionet nga pronarët e tokave dhe publiku gjatë kësaj periudhe të shqyrtimit publik, duhet të përpilohen në një raport nga shqyrtimi publik. Gjatë kësaj periudhe duhet të bëhet një seri aktiviteteve për konsultim publik (më shumë për shqyrtim publik shih në seksionin 3.5.1.2.).

Për më tepër, autoritetet e planifikimit hapësinor të komunikojë me publikun duke hartuar dhe publikuar Raportet vjetore të monitorimit mbi zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në dokumentet e planifikimit.

1.2. Pse është rëndësishme pjesëmarrja e publikut në proceset e planifikimit hapësinor?

Pjesëmarrja e publikut në planifikim hapësinor është e rëndësishme sepse:

Pajtueshmëria me ligjin: Përfshirja e publikut në të gjitha fazat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor është kërkesë e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;

Fuqizimi i komunitetit: Pjesëmarrja publike ndikon që qytetarët të jenë më të informuar mbi planet hapësinore, mundëson shkëmbim njohurish dhe të përvojave të tyre duke ndikuar kështu në fuqizimin e komunitetit.

Krijimi i pritshmërisë reale lidhur me rezultatet nga proceset zhvillimore të planifikimit hapësinor: Planet hapësinore të zhvilluara me pjesëmarrje publike, adresojnë më mirë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe kjo rezulton në një produkt final që është më i mirë dhe më i lehtë për të u zbatuar;

Krijimi i ndjenjës së pronësisë: Duke qenë pjesë e procesit, tek qytetarët krijohet ndjenja e pronësisë për planet, dhe e rritë përgjegjshmërinë e qytetarëve për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave zhvillimore të planeve;

Ndërtimi i besimit të ndërsjellë në mes qytetarëve dhe vendimmarrësve: Pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit siguron transparencë dhe i jep legjitimitet vendim-marrjes. Kjo mundëson zvogëlimin e konflikteve eventuale gjatë zbatimit të zgjidhjeve të propozuara;

Sigurimi i mjeteve për financim: Jo gjithmonë qeveritë lokale kanë mjete të mjaftueshme për të zbatuar qëllimet dhe objektivat e dokumenteve të planifikimit hapësinor. Banorët lokal mund të sjellin burime shtesë për financimin e zbatimit të planeve. Nga ana tjetër, projektet që e kanë të zhvilluar edhe komponentin e pjesëmarrjes së publikut, kanë mundësi më të madhe të zbatimit dhe po ashtu vlerësohen më lart nga ana e donatorëve për mundësi financimi.

Njohja dhe kuptimi i kontekstit lokal: Banorët lokalë janë padyshim burimi më i mirë i njohurive dhe nevojave për mjedisin e tyre rrethues. Trajtimi me kujdes i nevojave dhe integrimi i kërkesave të paraqitura në plane, ndihmon draftimin e dokumenteve të planifikimit të cilat iu përgjigjen nevojave të qytetarëve.

Përveç përfitimeve që sjell pjesëmarrja publike gjatë procesit të planifikimit hapësinor, ajo ka edhe kërkesa që duhet të merren parasysh:

- Pjesëmarrja e publikut kërkon kohë dhe ka kosto: Cilido aktivitet i konsultimit të publikut kërkon njoftim publik, aranzhime rreth organizimit, përgatitjes së materialeve punuese dhe prezantimeve. Të gjitha këto veprime kërkojnë kohë, angazhim shtesë të resurseve njerëzore dhe buxhet për realizimin e tyre, e që shpeshherë kjo perceptohet nga autoritetet si ngadalësim i procesit të vendim-marrjes;
- Pjesëmarrja e publikut kërkon guxim dhe vullnet politik të vendim-marrësve: Vendimmarrësit duhet të jenë të përgjegjshëm para publikut lidhur me të gjitha zhvillimet që ndodhin dhe duhet të japin sqarime kurdoherë që është e nevojshme. Në rast të dështimeve eventuale, ata duhet të tregohen të guximshëm në ballafaqimin me qytetarët;
- Pjesëmarrja e publikut kërkon përfaqësim të barabartë- Autoritetet përgjegjëse për planifikim hapësinor, duhet të sigurojnë që interesat e të gjitha palëve janë adresuar, janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe me respekt;
- Verifikimi i informacionit – Gjatë pjesëmarrjes në proces publiku mund të ketë mendime të bazuara në informacione të pasakta, prandaj çdo informacion i marrë nga ata duhet të vlerësohet me kujdes.

Për vendimmarrësit është më e lehtë të fillojnë procesin e planifikimit pa pjesëmarrje të publikut dhe të vendosin vetë mbi planet hapësinore. Duke ndjekur këtë rrugë, ata mund të mos jenë në gjendje të gjykojnë nëse vendimet janë të pranueshme prej komunitetit. Rezistenca e mundshme ndaj këtyre vendimeve do të ngadalësonte zbatimin e tyre ose do të mund t'i ndalte tërësisht zhvillimet e planifikuara. Të gjitha përfitimet e stave të procesit të planifikimit do të shkonin në dëm gjatë fazës së zbatimit. Prandaj, planifikimi hapësinor me pjesëmarrjen e publikut është bërë një standard mbizotërues. Ndonëse nevojitet një periudhë përgatitore më e gjatë, përfitimet afatgjata i kompensojnë burimet e investuara.

1.3. Kush e udhëheq procesin e pjesëmarrjes së publikut në planifikim hapësinor?

Procesi i pjesëmarrjes së publikut në planifikim hapësinor duhet të udhëhiqet nga Autoriteti përgjegjës Komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor me mbështetje të fuqishme të vendim-marrësve (Kryetarit, Kuvendit të Komunës, Këshillit të drejtorëve) si dhe stafin e kyçur në marrëdhënie me publikun p.sh. zyrtarëve të informimit.

Qytetarët gjithashtu kanë përgjegjësitë e tyre si p.sh. gatishmëri të kontribuojnë në proceset e planifikimit dhe të kenë qasje pozitive dhe të shprehin idetë dhe mendimet e tyre në mënyrë të qartë për të mundësuar një bashkëpunim konstruktiv.

Autoritetet Planifikimit Hapësinor komunale duhet të jenë të gatshëm për të inkurajuar, menaxhuar dhe për të edukuar qytetarët lidhur këto përgjegjësi. Ata duhet të jenë më të hapur për përfshirje më të madhe të publikut dhe të lehtësojnë fuqizimin e komunitetit.

1.4. Kur realizohet pjesëmarrja e publikut në planifikim hapësinor?

Pjesëmarrja e publikut duhet të ndodh në mënyrë të vazhdueshme gjatë të gjitha fazave të procesit të planifikimit hapësinor, por jo domosdoshmërisht në secilin aktivitet brenda këtyre fazave. Niveli dhe teknika/metoda e duhur e pjesëmarrjes përcaktohet nga qëllimi i pjesëmarrjes për secilën fazë të planifikimit. Si rregull i përgjithshëm, publiku duhet të përfshihet kur planerët janë të gatshëm të përmbushin cilindo nga qëllimet e pjesëmarrjes për ta realizuar me sukses aktivitetin.

Qëllimet e pjesëmarrjes së publikut në fazat e planifikimit janë:

Informimi – nënkupton që publiku duhet të jetë i informuar për aktivitetet e planifikimit dhe të pjesëmarrjes para se të ndodh pjesëmarrja;

Edukimi – nënkupton përgatitjen dhe aftësimin e publikut për pjesëmarrje në mënyrë produktive dhe efektive gjatë procesit të planifikimit;

Inputi – Planerët kanë nevojë të plotësojnë ose verifikojnë informacionin faktik përmes përvojave, qëndrimeve ose pikëpamjeve praktike të publikut;

Vendim-marrja – nënkupton vullnetin e publikut për kontribut në vendim-marrje para se ata të pranojnë zhvillimet e propozuara të planifikimit ose planin.

Burimi: Marrë dhe përshtatur nga "Crafting an Effective Plan for Public Participation", (2004)

Kapitulli II:

Parimet e pjesëmarrjes së publikut në proceset e planifikimit

Planifikimi me pjesëmarrje është proces që kërkon të përfshijë palët kyçe të interesit në proces për të siguruar informimin, bashkëpunimin dhe për të fituar përkushtimin e tyre për të kontribuar në proceset e planifikimit. Pjesëmarrja publike në planifikim hapësinor, është e ndërtuar mbi disa parime bazë të pjesëmarrjes publike dhe të qeverisjes ku përfshihen:

- Gjithë përfshirja
- Transparenca dhe informimi
- Qasshmëria
- Përgjegjshmëria
- Barazia dhe llojllojshmëria
- Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria

2.1. Gjithë përfshirja

Parimi i gjithë përfshirjes nënkupton që secili individ apo palë e interesit pavarësisht moshës, gjinisë, racës, nacionalitetit etj., ka të drejtë të marrë pjesë në proceset e planifikimit që zhvillohen në komunën/vendbanimin apo lagjen e tyre.

Qëllimi kryesor i këtij parimi është të sjellë së bashku të gjitha grupet kyçe të palëve të interesit (qytetarët, komunitetin e biznesit, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarët e qeverisë lokale e qendrore, përfaqësues të grupeve të cenuara etj.) duke ju ofruar mundësinë të shpalosin shqetësimet, shprehin mendimin dhe qëndrimet tyre dhe kontribuojnë mbi zhvillimet hapësinore në komunën e tyre.

Që proceset e planifikimit të kenë sukses sa i përket gjithë përfshirjes duhet që autoritetet përgjegjëse komunale për planifikim dhe menaxhim hapësinor të përdorin teknika adekuate për secilën fazë të planifikimit dhe metoda të pjesëmarrjes së publikut përmes të cilave do të inkurajohet pjesëmarrja. Detajet rreth këtyre teknikave janë të përshkruara në kapitullin e 3-të.

Këshilla praktike:

1. Sigurohu që pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit hapësinor të përfshijë një gamë të plotë, të balancuar dhe të llojllojshme të grupeve të interesit;
2. Sigurohu që këtyre grupeve t'ju jepet mundësia e shprehjes së brengave, interesave të tyre dhe që konfliktet eventuale të adresohen dhe ofrohet mbështetje në zgjidhjen e tyre;
3. Përdor forma të ndryshme të angazhimit për të siguruar përfshirjen e duhur të palëve të interesit;
4. Keni parasysh edhe subvencionimin e pjesëmarrjes për ndonjë grup të caktuar të interesit. Kjo mund të përfshijë shpenzimet e udhëtimit apo organizimin e transportit;

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.



Foto 1: Përfaqësues të komunës, qeverisë qendrore, komunitetit të biznesit, grupeve të ndryshme të shoqërisë civile, profesionistë e ekspertë diskutojnë mbi problemet e zbatimit të Planeve Rregulluese Urbane në komunën e Prishtinës. Rezultatet nga këto punëtori do të shfrytëzohen gjatë hartimit të Hartës Zonale të komunës.



Foto 2: Përfaqësues të GKK, qeverisë qendrore dhe lokale si dhe qytetarë diskutojnë rreth vizionit të ardhshëm të komunës gjatë punëtorisë së Vizionimit në procesin e revidimit të PZHK-së, Vushtrri

2.2. Transparenca dhe informimi

Transparenca në kuptimin e plotë të fjalës do të thotë “shkëmbimi i informacionit dhe të vepruarit në mënyrë të hapur”. Kjo do të thotë se procesi i planifikimit duhet të jetë transparent, i hapur për të gjithë dhe të sigurojë që informacioni në lidhje me procesin e vendimmarrjes dhe informacioni mbështetës për planin janë në dispozicion të publikut për shqyrtim dhe komente.



Foto 3: Raportimi në mediat nacionale mbi aktivitetet e pjesëmarrjes së publikut në komunën e Prishtinës

Autoriteti komunal përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin hapësinor është i detyruar të ndërmarrë një fushatë informuese për të siguruar dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e publikut në hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit, duke përdorur kanale të qëndrueshme dhe të përshtatshme të komunikimit.

Kjo gjithashtu do të thotë se vendimmarrësit janë të hapur për të mësuar nga palë të ndryshme të interesit, të marrin në konsideratë idetë e tyre, dhe të japin përgjigje se si idetë e tyre janë pasqyruar në planin hapësinor. Aplikimi i këtij parimi në praktikë ka një efekt të madh në të kuptuarit e publikut dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e planifikimit. Kjo mundëson krijimin e dialogut dhe besimit ndërmjet palëve, ofron zgjidhje më të mira, shmang agjendat e dyfishta apo dyshimet midis palëve dhe po ashtu shmangë situatat e konfliktit ku disa palë vetëm mund të mbrojnë interesat e tyre dhe nuk janë bashkëpunues në gjetjen e një kompromisi.

Këshilla praktike:

- Përdorni mediat sociale (facebook, twitter), portalet elektronike, për të përcuar sa më shpejtë dhe në mënyrë sa më efikase informatën.
- Për takimet me fokus grupet dhe përfaqësuesit e institucioneve lokale apo qendrore, përfaqësuesit e kompanive publike etj. shfrytëzoni formën zyrtare të informimit përmes ftesave individuale në formë të shtypur ose elektronike me email, informimin me telefon etj.
- Informoni me kohë pjesëmarrësit në mënyrë që ata të përshtatin agjendat e tyre;
- Ofroni materialet paraprakisht në mënyrë që ata të përgatiten për dhënien e kontributit në takime;
- Komunikoni në gjuhë jo-teknike me banorët;
- Sigurohuni që prezantimet për publikun të arrijnë të kuptohen nga secili pjesëmarrës apo palë interesi;
- Mbajini pjesëmarrësit të informuar rreth zhvillimit të proceseve të planifikimit në vazhdimësi duke i informuar qartë dhe drejt rreth planeve të komunës;
- Ofroni palëve të interesit dhe publikut në përgjithësi qasje në dokumentet e planifikimit përmes veb-faqes së komunës, organizimit të takimeve publike në të cilat diskutohen rekomandimet e planeve dhe ndikimi i këtyre rekomandimeve në jetën e tyre dhe pronat e qytetarëve; Planifikoni me kohë koston e cila ndërlidhet me informimin e qytetarëve;
- Në rastet kur pjesëmarrja e publikut në aktivitete të planifikimit hapësinor rezulton të jetë e ulët, është e rëndësishme të hulumtohen teknika të ndryshme për informim në mënyrë që pjesëmarrja të rritet. Hartimi i ftesave të vogla (formati A6) dhe shpërndarja e tyre nëpër dyqanet më të frekuentuara në lagje (mishtore, supermarket, furrë etj.) ka rezultuar me ngritje të numrit të qytetarëve në takime publike.

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.

2.3. Qasshmëria

Nënkupton mundësinë për t’ju siguruar pjesëmarrësve qasje të lehtë pjesëmarrjeje në aktivitetet e planifikimit hapësinor që zhvillohen në komunën/vendbanimin apo lagjen e tyre. Kjo në radhë të parë ka të bëjë më atë se asnjë pjesëmarrës nuk është i përjashtuar nga aktivitetet e pjesëmarrjes së publikut për shkak të pamundësisë së qasjes në vendtakimet, kohës ose pengesave gjuhësore.

Autoritetet komunale përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin hapësinor duhet të bëjnë përpjekje që këto kushte janë plotësuar kur të planifikojnë aktivitete të pjesëmarrjes publike. Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet grupeve të cenuara dhe personave me nevojë të veçanta.

Barrierat që mund të pengojnë qasjen e publikut për pjesëmarrje në aktivitetet e planifikimit hapësinor përfshijnë:

- Mjetet financiare- palët të caktuara të interesit mund të mos kenë para për të siguruar udhëtimin për pjesëmarrje në takimet e ndryshme;
- Koha – Koha e caktuar për mbajtjen e takimeve mund të mos jetë e përshtatshme për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve të caktuara të interesit në proceset e planifikimit hapësinor në komunë;
- Qasja në lokacion – Publiku apo grupe të caktuara të interesit mund të jetojnë në lokacione të largëta apo edhe vështirë të qasshme.;
- Qasja në informacion – publiku apo grupe të caktuara të interesit mund të mos kenë qasje adekuata në informim për proceset e planifikimit;
- Gjuha – publiku apo grupe të caktuara të interesit mund të mos e kuptojnë terminologjinë teknike e cila përdoret gjatë aktiviteteve pjesëmarrëse., dhe po ashtu ata mund të jenë përfaqësues të komuniteteve të ndryshme;

Praktika të mira

- Shfrytëzimi i objekteve publike për mbajtjen e takimeve: shkollat, sallat e restoranteve dhe mjediset që janë lehtë të qasshme në këmbë dhe me transport publik dhe të rehatshme për të gjitha palët e interesit ka treguar se ka efekt pozitiv në procesin e pjesëmarrjes së publikut;
- Organizimi i takimeve në objektet e trashëgimisë kulturore (kur është e mundur), nxit përkushtimin e pjesëmarrësve dhe krijon ndjenjën e përkatësisë (p.sh Mbajtja e punëtorisë së vizionimit si dhe takimit tematik mbi “Trashëgiminë kulturore në Kalanë e Vushtrrisë);
- Mbajtja e takimeve në hapësirat të cilat nuk kanë barrierë fizike ka mundësuar pjesëmarrjen edhe të moshuarve, personave me nevoja të veçanta etj;
- Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit rreth organizimit të takimeve (p.sh Organizimi i punëtorive në objekte hoteliere ka ofruar mjedis të rehatshëm për pjesëmarrësit dhe ka zvogëluar koston e pjesëmarrjes publike – shembulli i komunës së Prishtinës);
- Planifikimi i takimeve me publikun apo palët e interesit në orarin që ju përshtatet atyre ka mundësuar pjesëmarrje më të madhe;
- Qasja derë më derë në lidhje me informimin e banorëve për aktivitetet e planifikimit hapësinor që zhvillohen në lagjen e tyre ka dhënë rezultate pozitive;
- Organizimi i transportit për personat me nevoja të veçanta dhe qytetarët që nuk kanë qasje në mjete transporti dhe transport publik gjithashtu ka rezultuar me pjesëmarrje më të madhe të publikut;
- Gjuha e përdorur në materialet informuese duhet të jetë lehtësisht e kuptueshme, dhe në gjuhët respektive të komuniteteve.
- Të shikohet mundësia e komunikimit edhe përmes formave elektronike (veb-faqes, lajmeve dhe debateve direkt radio-televizive dhe formave tjera), marrjes së mendimit përmes kontaktit të drejtpërdrejtë (shtëpi në shtëpi), etj.

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.



Foto 4: Kontaktet derë më derë me qytetarë (foto në të majtë) dhe në vend pune (foto në të djathtë)



Foto 5: Mbajtja e takimit në sallën e edukatës fizike të shkollës (foto majtas) dhe në restaurant (foto në të djathtë)



Foto 6: Prezantimi i skenarëve të zhvillimit hapësinor në sallën e Kuvendit Komunal në Vushtrri (foto majtas) dhe takimi me rininë në shkollën e Kompetencës në Malishevë (foto në të djathtë)

2.4. Llogaridhënia

Llogaridhënia nënkupton përgjegjësinë dhe aftësinë për të ofruar shpjegim dhe arsytim për zgjedhjet dhe vendimet që ndërmerren mbi zhvillimet hapësinore në komunë. Ky parim, para së gjithash ka të bëjë me ndërtimin e besimit të ndërsjellë në mes të qytetarëve dhe autoriteteve të komunës. Autoritetet Planifikimit Hapësinor Komunal janë të detyruar të japin llogari se si janë duke u përdorur inputet e marra nga qytetarët përmes procesit të pjesëmarrjes së publikut.

Vendimmarrësit duhet të kenë parasysh që për qytetarët është e domosdoshme të krijohet bindja se kontributi i tyre vlerësohet dhe do të merret parasysh gjatë proceseve vendimmarrëse të komunës në planifikim hapësinor. Gjatë gjithë procesit të pjesëmarrjes së publikut, shënimet dhe procesverbali mbahet rregullisht dhe rezultatet duhet të komunikohen dhe të bëhen publike.

Praktika të mira

Pjesëmarrja e vendimmarrësve në takime publike, duke i dëgjuar problemet e qytetarëve për së afërmi dhe konfirmuar se ato do të trajtohen në dokumentet e planifikimit hapësinor rezulton në ngritjen e besueshmërisë në mes të vendimmarrësve dhe qytetarëve. Drejtori i drejtorisë së planifikimit hapësinor në komunë duhet të jetë në gjendje të përcjellë të gjitha takimet publike të cilat kanë të bëjnë me planifikim hapësinor. Moderimi i takimeve publike dhe përgjigjet direkte nga vendimmarrësit drejt qytetarëve është një shembull i mirë si të arrihet ky parim. Pjesëmarrja e drejtorëve në këto takime ka dëshmuar ngritjen e besimit të qytetarëve ndaj komunës, dhe kjo ka shërbyer për të sqaruar ose përgjigjur për çdo çështje në zhvillim që ka nevojë për një përgjigje nga një vendim-marrës komunal. Duke marrë pjesë në takime publike, drejtori i një drejtorie komunale të planifikimit urban siguron se komuna është duke marrë masat e duhura për të rritur bashkëpunimin midis qytetarëve dhe drejtorisë së planifikimit urban dhe kështu do të jetë e përgjegjshme për politikën e saj zhvillimore.

Burimi: Nga praktikën e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivel lokal”

2.5. Barazia dhe llojllojshmëria

Në pjesëmarrjen e publikut në aktivitetet e planifikimit hapësinor është me rëndësi të kuptohet qysh në fillim e drejta për pjesëmarrjen e të gjithë individëve/grupeve të përfaqësuara pa dallim race, gjinie, religjioni, kombësie, moshe etj. Aspektet e barazisë gjinore dhe minoriteteve, si dhe nevojat specifike të personave me aftësi të veçanta, të rinjve, grave, fëmijëve, të moshuarve etj., duhet të adresohen me kujdes dhe me ndjeshmëri.

Kur flitet për llojllojshmërinë e para që vjen ndërmend janë aspektet që kanë të bëjnë me gjininë, racën, kombësinë dhe moshën. Por në proceset e planifikimit hapësinor, nevoja për llojllojshmëri përfshin një gamë më të gjerë se sa grupet e lartpërmendura. Dhe kjo ka të bëjë me dallimet të asocuara edhe me statusin social brenda komunitetit, dallimet e ndërlidhura me aspektin territorial (lokacionin gjeografik), dallimet në mirëqenien ekonomike, dallimet në përkatësitë politike, dallimet në përvojën e punës etj. Këto dallime duhet të lejohen të dalin në sipërfaqe dhe kur është e përshtatshme, autoritetet e planifikimit duhet të kërkojnë mënyra për të gjetur një konsensus.

Autoritetet komunale përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor duhet të reflektojnë paanshmëri dhe të sigurojnë që të gjitha grupet e caktuara të trajtohen në mënyrë të barabartë, si dhe interesat e tyre të trajtohen me seriozitet.

Këshilla praktike:

- Sigurohu që grupet e caktuara të interesit të kenë përfaqësim në takimet publike dhe në veçanti në mekanizmat e përfaqësimit siç është Grupi Këshillëdhënës i Komunitetit (GKK)- shih më gjerësisht për GKK-në në kapitullin III;
- Ofroni mundësi pjesëmarrjeje dhe shprehje të mendimit grupeve të ndryshme etnike duke ju ofruar mundësinë që të shprehen lirshëm në gjuhën e tyre. Ofroni përkthim adekuat gjatë takimeve;
- Dëgjoni me kujdes nevojat dhe brengat e grupeve të cenuara;
- Organizoni takime të veçanta me grupet e tilla nëse e shihni të nevojshme. P.sh takimet e përfshirjes së femrës në diskutimin e skenarëve zhvillimore në procesin e revidimit të PZHK-së së Vushtrrisë, takimi konsultativ me të rinjtë e fshatrave të Malishevës në të cilat u parashtruan kërkesat dhe ofruan ide për zgjidhjen e tyre në PZHK;
- Sigurohu që secili pjesëmarrës në takimet publike të merr përgjigjen e merituar gjatë procesit të planifikimit hapësinor.

Burimi: Nga praktikën e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.

2.6. Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria

Lejimi i fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë nënkupton aftësinë për të krijuar mundësi për ndryshime dhe përshtatje në mënyrë që të rritet cilësia e procesit të pjesëmarrjes publike. Gjatë kontakteve me palët e interesuara, ka të ngjarë se mund të dalin në pah informacione të reja dhe rrethana të paparashikuara. Mund të jetë e nevojshme që disa aktivitete duhet të ri-organizohen në mënyrë që të përshtaten me kushtet e reja. Fleksibiliteti në kuptimin e ndryshimit dhe përshtatshmërisë të aktiviteteve të pjesëmarrjes publike në aspektin kohor dhe metodologjik mund të jetë i nevojshëm për t'iu përshtatur rrethanave të reja dhe lehtësuar pjesëmarrjen publike maksimale. Planifikimi i hershëm do të lejojë fleksibilitet sa i përket aspektit kohor dhe do të ndihmojë planerët të jenë të përgaditur paraprakisht për çdo aktivitet pjesëmarrjes së publikut.

Praktika të mira:

- Të jeni të përgatitur me alternativa shtesë për angazhim të palëve të interesit, sepse me nxjerrjen në pah të nevojave dhe çështjeve, rrethanat mund të ndryshojnë prandaj mund të paraqitet nevoja për ndryshime në proces. Kjo nënkupton ndryshimet qoftë në metodologjinë e punës, teknikat e pjesëmarrjes por edhe ndryshimet nga aspekti kohor dhe tekniko-logjistik;
- Merrni në konsideratë vlerat unike të lokalitetit për të përshtatur dhe gjetur metodat e duhura të pjesëmarrjes së publikut për atë lokalitet/vendbanim;

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.

Kapitulli III:

Plani për pjesëmarrjen e publikut në proceset e planifikimit hapësinor në nivel lokal

Plani i pjesëmarrjes së publikut (PPP) duhet të përpilohet qysh në fazat fillestare të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. PPP duhet të përmbajë të gjitha aktivitetet e pjesëmarrjes publike së bashku me teknikat dhe metodat adekuate të angazhimit të palëve të interesit në secilën fazë të planifikimit dhe atë të zbatimit.

PPP gjithashtu duhet të merr parasysh kontekstin e komunës dhe llojin e dokumentit të planifikimit hapësinor. Gjatë hartimit të planit të pjesëmarrjes së publikut duhet të merren parasysh shkalla e ndikimeve, ndjeshmëria e vendbanimit/ lagjes së prekur dhe karakteri i komunitetit i cili mund të ndikohet nga zhvillimet e propozuara në dokumentin e planifikimit në fjalë. Prandaj është me rëndësi që gjatë hartimit të PPP, autoritetet komunale përgjegjëse për planifikim hapësinor të bashkëpunojnë me OJQ-të lokale dhe palë tjera të përfshira në proces.

Procesi i përgatitjes së PPP përfshin hapat si në vijim:

3.1. Hapi 1: Përgatitjet për pjesëmarrjen e publikut në aktivitetet e planifikimit

Në këtë fazë vendosen themelet për mbarëvajtjen dhe arritjen me sukses të rezultateve të dëshiruara nga procesi i pjesëmarrjes së publikut. Në praktikë kjo fazë zakonisht merr një deri dy muaj kohë dhe përfshin:

- Organizimin e punës
- Ndërtimin e partneriteteve

3.1.1. Organizimin e punës

Ky hap përfshin të gjitha ato aktivitete përgatitore që duhet të ndërmerren rreth organizimit të pjesëmarrjes së publikut në ndonjë proces të planifikimit hapësinor që zhvillohet në komunë si:

- caktimi i udhëheqësit të projektit dhe grupit punues nga ana e komunës,
- definimi i resurseve financiare dhe atyre njerëzore brenda komunës apo dhe jashtë saj (nëse projekti përkatës ndihmohet nga ndonjë donator eventuale), dhe
- definimi i rolit dhe përgjegjësi të secilit person.

3.1.2. Ndërtimi i partneriteteve

Pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit hapësinor ka të bëjë edhe me ndërtimin e partneriteteve në mes të komunës, OJQ-ve lokale apo edhe Organizatave me bazë komuniteti; partneritet me komunat tjera, institucionet e nivelit qendror dhe sektorin privat.

Bashkëpunimi me Organizatat e shoqërisë civile: Arsyeja e ndërtimit të partneriteteve me organizatat lokale të shoqërisë civile apo organizatat me bazë komuniteti është se këto organizata e njohin më së miri kontekstin lokal dhe mund të ndihmojnë në identifikimin dhe bashkëveprimin me grupet e caktuara të interesit. Njëherësh ato mund të shërbejnë si një urë lidhëse në komunikimin me komunitetin dhe të lehtësojnë qasjen tek ta.

Praktika të mira

Komuna e Malishevës ka angazhuar një OJQ lokale rinore për mobilizimin e rinisë në dhënien e kontributit në Planin Zhvillimor Komunal të Malishevës. Gjatë aktiviteteve pjesëmarrëse të PZHK, aktivitetet që përfshijnë ndihmën logjistike si shpërndarjen e ftesave, përgaditjen e vendtakimit por edhe angazhimi në shpërndarjen e informatave me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së rinisë në aktivitetet pjesëmarrëse të planifikuara, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë gjinore dhe të personave me nevoja të veçanta, janë disa nga punët vullnetare që janë ofruar nga të rinjtë (anëtarë të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal-KVRL), Qendrës Rinore, Qendrës për Avokim dhe Diplomaci si dhe përfaqësuesve të organizatës HANDIKOS për rini. Përveç kontributit në planin strategjik për komunitetin e tyre, këta të rinj janë bërë më të ndërgjegjshëm mbi procesin e planifikimit.

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.



Foto 7: Të rinjtë e zonave rurale dhe qytetit të Malishevës diskutojnë mbi Planin Zhvillimor Komunal

3.2. Hapi 2: Identifikimi i palëve të interesit

Palë e interesit nënkupton individ, grup, institucion apo subjekt që direkt apo indirekt ndikon në procesin e planifikimit ose mund të ndikohet nga zhvillimet e planifikuara. Në terminologjinë shqipe shpesh ky term mund të haset edhe me sinonimin “Akerë”, “Hisedarë” apo “Grupe të interesit”. Janë katër grupe kryesore të cilat do të kenë interes në vendimet të cilat do të merren nga qeveria lokale

- Kuvendi komunal
- Administrata lokale
- Shoqata të komunitetit (grupe të organizuara të komunitetit, organizatat joqeveritare, etj) dhe grupe të veçanta të interesit (kompanitë e shërbimeve publike, komunitetit të biznesit dhe investitorëve, shoqata profesionale, etj) dhe
- Publiku i gjërë.

Një teknikë e përdorshme për identifikimin e palëve të interesit është ajo e Identifikimit të palëve të interesit/akterëve (Stakeholder mapping). Në praktikë ky hap zakonisht përfshin një analizë gjatë së cilës identifikohen akterët të cilët përfshijnë , grupet apo subjektet që kanë interes qoftë të vogël apo të madh dhe që janë të ndikuar më shumë ose më pak nga zhvillimet hapësinore në komunë/vendbanim apo lagje, të klasifikuara sipas kategorive:

- Palët e interesit që ndikohen më shumë prej zhvillimeve hapësinore të prapara me plan (banorët, bizneset, pronarët e tokave, etj.);
- Palët e interesit që ndikojnë në zbatimin e aktiviteteve të planifikimit (politikanë, investitorë etj.);
- Palët e interesit që mund të kontribuojnë me ekspertizë apo informacion (OJQ, organizatat me bazë komuniteti, komunitetet e organizuara të biznesit dhe profesionistëve, përfaqësues të mediave etj.).

Kjo analizë duhet të punohet bashkërisht me partnerët e përfshirë në proces.

Këshilla praktike

Gjatë përpilimit të listës së palëve të interesit, kujdesuni që:

- Keni identifikuar palët më të rëndësishme të interesit;
- Është kuptuar dhe definuar qartë roli, përgjegjësia si dhe interesi i tyre;
- Konfliktet në mes të palëve të ndryshme të interesit janë identifikuar;
- Janë marrë parasysh grupet që tashmë janë të formuara si: përfaqësuesit e lagjeve urbane, përfaqësuesit e këshillave të fshatrave, përfaqësuesit e bizneseve, përfaqësuesit e të rinjve, përfaqësuesit e komuniteteve fetare etj.
- Janë marrë në konsideratë edhe përfaqësuesit e grupeve të cilët zakonisht nuk janë përfshirë apo janë anashkaluar.
- Bëni përpjekje që të përfshini një gamë të gjerë të përfaqësuesve të qytetarëve (gratë, pensionistët, minoritetet, të rinjtë etj).

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.

3.3. Hapi 3: Themelimi i Grupit Këshillëdhënës të Komunitetit

Krijimi i një trupi pjesëmarrës i cili e përfaqëson komunitetin në të gjitha aktivitetet e planifikimit është e rëndësishme për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e pjesëmarrjes publike në të gjitha fazat dhe planet . Grupi Këshillëdhënës i Komunitetit (GKK) është një nga mekanizmat më të përdorshëm të përfaqësimit të publikut. Grupi zakonisht ka në përbërje një numër të konsiderueshëm të vullnetarëve nga komuniteti të cilët përfaqësojnë interesa të ndryshme, pikëpamje apo fushë të ekspertizës përbrenda komunitetit.

GKK është trup përfaqësues i pavarur i qytetarëve i cili duhet të jetë jo-politik. Edhe pse GKK nuk trup vendimmarrës, ai ka ndikim domethënës në zhvillimin e procesit të planifikimit.

Çfardo barriere që mund të ndikojnë në punën e një GKK duhet të identifikohet që në fillim dhe të adresohet në mënyrë të përshtatshme. Ato mund të përfshijnë: mungesën e fondeve për kompensimin e anëtarëve të GKK-së, barrierat gjeografike për disa prej anëtarëve të GKK për të marrë pjesë në takime, mungesa e mjeteve për shpenzimet logjistike dhe organizimin e takimeve, etj

Praktika të mira të funksionimit të GKK janë zhvilluar në disa komuna, ku GKK-të kanë shërbyer si një urë lidhëse në lehtësimin e dialogut mes komunitetit dhe autoriteteve komunale të planifikimit hapësinor.

Roli dhe përgjegjësitë e Grupit Këshillëdhënës të Komunitetit

- Të kontribuojnë në ngritjen e kualitetit dhe përfshirjen e shoqërisë civile dhe komunitetit në proceset e planifikimit që zhvillohen në komunë;
- Të ndikojnë në ndërtimin e konsensusit publik mbi çështjet e planifikimit hapësinor dhe urban para se komuna të merr vendim për çështje të caktuar;
- Të sigurojnë proces transparent të pjesëmarrjes së publikut në proceset e planifikimit hapësinor;
- Të ofrojnë këshilla profesionale mbi çështjet e planifikimit hapësinor dhe urban në komunë, planet apo dokumentet tjera strategjike për komunë;
- Të propozojnë zgjidhje, masa dhe rekomandime për planifikim hapësinor;
- Propozojnë zgjidhje dhe rekomandime për menaxhim efikas të strukturave komunale përgjegjëse për planifikim hapësinor etj.

Praktika të mira të funksionimit të GKK

Gjatë planifikimit të revitalizimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë, Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM) ka themeluar Grupin Këshillues të Komunitetit (GKK) si një mekanizëm për nxitjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të publikut në këtë proces. GKK është përbërë nga: përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të komunitetit nga zona e planit dhe përfaqësues të institucioneve relevante (15 persona), të cilët janë identifikuar në bashkëpunim me një OJQ lokale. Qëllimi primar i GKK ka qenë të mbajë një komunikim të hapur dhe efektiv ndërmjet qytetarëve, bizneseve, banorëve të zonës, organizatave të komunitetit dhe institucioneve relevante me qeverinë komunale. Gjatë punës së tij, GKK ka dhënë kontribut të vlefshëm për qeverinë lokale në lidhje me prioritetet e komunitetit lidhur me regjenerimin e Çarshisë së Madhe.

Organizimi i komunitetit dhe palëve të interesit nga zona e Çarshisë në një mekanizëm si GKK ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në formulimin e një strategjie e cila ka harmonizuar dhe integruar nevojat dhe interesat e të gjithë pjesëmarrësve. Puna gjatë takimeve të GKK-së dhe njoftimi i tyre me metodologjinë dhe teknikat e planifikimit strategjik, ka ndikuar në fuqizimin e komunitetit për pjesëmarrje aktive në procese të planifikimit hapësinor. Përkushtimi i GKK-së gjatë procesit ka nxitur iniciimin e një bashkëpunimi të ardhshëm të GKK-se me DUMM për pjesëmarrje aktive në procesin e hartimit të PRRH për zonën e Çarshisë të iniciuar së voni nga komuna.

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”.



Foto 8: Në takimin e themelimit, anëtarët e GKK-se shprehën të kënaqur me iniciativën e projektit dhe zotohen për përkushtim në zbatimin e aktiviteteve të projektit në komunën e Gjakovës



Foto 9. Takimet me Grupin Këshillëdhënës të Komunitetit në komunën e Prishtinës

3.4. Hapi 4: Hartimi i planit të veprimit për pjesëmarrjen e publikut (PPP) gjatë proceseve të planifikimit hapësinor

Hartimi i planit të veprimit për pjesëmarrje publike kërkon përcaktimin pikave të mëposhtme:

- aktiviteteve që kërkojnë pjesëmarrjen e publikut dhe detyrave që duhet të kryhen në kuadër të aktivitetit;
 - komuniteti/ grupi i synuar;
 - definimin e rezultateve të pritshme nga secili aktivitet;
 - identifikimi i qasjes, nivelit dhe të teknikave të pjesëmarrjes së publikut në kuadër të aktivitetit;
 - caktimin e datës, vendit (lokacionit) ku do të zhvillohet aktiviteti i pjesëmarrjes së publikut dhe kohëzgjatjes së tij;
 - identifikimin e institucionit apo individit përgjegjës për organizimin e aktivitetit të pjesëmarrjes;
 - llogaritjen e kostos që implikon zbatimin e secilit aktivitet si dhe
 - burimin se nga sigurohet buxheti për zbatimin e aktivitetit.
- Aktivitetet dhe detyrat: Aktivitetet e pjesëmarrjes së publikut derivojnë nga plani i punës së dokumentit të planifikimit hapësinor që mund të jetë Plan Zhvillimor Komunal, Hartë Zonale e Komunës, Plan Rregullues i Hollësishëm, projekte të dizajnit urban apo projekte tjera të ndërlidhura me fushë veprimtarinë e planifikimit hapësinor në komunë (shih shembullin në Tabelën 1).
 - Grupet e synuara: Për secilin aktivitet të pjesëmarrjes së publikut duhet të identifikoni grupin e caktuar të njerëzve dhe rolet e tyre duke analizuar:

- Cilat grupe duhet të përfshihen?
 - Çfarë kontributi pritet nga grupet apo individët e ndryshëm?
 - Cili është interesi i parashikuar i grupit në zhvillimet e propozuara në plan?
- c) Rezultatet e pritshme: Ka të bëjë me identifikimin e rezultatit i cili pritet të arrihet me përfundimin e secilës detyrë të specifikuar me PPP. Rezultatet e pritura përcaktohen varësisht nga niveli i pjesëmarrjes publike i cili është aplikuar në fazën e caktuar të hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor. Në varësi të kësaj, rezultatet e pritura mund të tërfishijnë:
- themelimi i fokus grupeve apo Grupit Këshilldhënës të Komunitetit,
 - marrja e informacioneve nga publiku dhe konsultimi lidhur me çështje të caktuara,
 - vetëdijësimi lidhur me procesin e planifikimit,
 - konsensusi për çështjet e identifikuar, vizionin, qëllimet dhe objektivat, prioritetet strategjike etj.
- d) Niveli dhe teknikat e pjesëmarrjes së publikut: Në kuadër të PPP kjo pjesë ka të bëjë me definimin e nivelit të pjesëmarrjes së publikut në secilin aktivitetet të planifikimit hapësinor si dhe të teknikave të pjesëmarrjes së publikut. Metodat dhe teknikat duhet t'ju përshtaten kontekstit specifik të aktivitetit të pjesëmarrjes dhe të jenë adekuate për temën (shih elaborim më të gjerë në Hapin 5: zbatimi i PPP). Për secilin nga nivelet e pjesëmarrjes përdoren metoda dhe teknika të cilat korrespondojnë me nivelit e pjesëmarrjes.
- Data, vendi dhe kohëzgjatja: Duhet të përcaktohet data reale dhe përzgjedhja e vendit për zbatimin e aktivitetit. Procesi pjesëmarrës duhet të harmonizohet me aktivitetet e hartimit të dokumentit të planifikimit dhe kohëzgjatjes së fazave të planifikimit. Nga ana tjetër, të qenit optimist më shumë se ç 'duhet gjatë vlerësimit të afateve kohore sidomos në rastet kur ka presion në proceset e planifikimit është normale, por nuk duhet lejuar që vonesat eventuale të kenë ndikim në rezultatin final.
- f) Personi përgjegjës dhe përfshirja e të tjerëve: Përcaktoni personin përgjegjës që do të përfshihet në procesin e pjesëmarrjes së publikut si dhe detyrat e tij. Përveç përgjegjësit duhet të evidentohen gjithashtu edhe të përfshirët tjerë (p.sh zyrtarë qeveritarë, anëtarë të zgjedhur, organizata të komunitetit, OJQ, etj.) të cilët do të jenë të përfshirë në çdo detyrë të PPP.
- g) Burimet e nevojshme: Nënkupton evidentimin e resurseve njerëzore, materialet e nevojshme, dhe pajisjet e përfshira në kryerjen e detyrës.
- h) Kostoja dhe burimi i financimit: Nënkupton përcaktimin e kostos të secilës detyrë.

Shih më gjerësisht shembullin e dhënë në Tabelën 1 të zhvillimit të Planit të pjesëmarrjes së publikut gjatë hartimit të strategjisë së funksionalizimit të hapësirës historike urbane - "Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe të Gjakovës".

Tabela 1: PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT PËR PJESËMARRJEN E PUBLIKUT GJATË HARTIMIT TË DOKUMENTIT "KORNIZA E FUNKSIONALIZIMIT PËR ÇARSHINË E MADHE NË GJAKOVË/ÇEMË" PLANI I VEPRIMIT PËR PJESËMARRJEN AKTIVE TË PUBLIKUT NË PROCESIN E HARTIMIT TË DOKUMENTIT

FAZAT	DETYRAT	GRUPE TË SYNUARA	REZULTATET E PRITURA	NIVELI PËSËMARRJES	TEKNIKAT E PËSËMARRJES	DATA/ VENDI	KOHËZGJATJA	PËRQËSIA	KOSTOJA	BURIMI I BURIMIT
FAZA PËRGATITORE	Identifikimi i aktoreve kyç dhe themelimi i Komitetit të ÇeM dhe GKK	DUMM	Grupi punues për ÇeM i themeluar	N/A		Janar/ Shkurt 2015	N/A	DUMM/MP CHWB/MP	N/A	Projekti i Burimit i Chemonics
	Diagjrami i planit të punës	Grupi këshillues i komunitetit (GKK)	- Pjesëmarrësit marrin pjesë në proces dhe GKK Marja e informave që mund të jenë të dobishme për procesin e planifikimit ose propozimi i personave që duhet të përfshihen në proces Njohje bazike e procesit të planifikimit dhe pjesëmarrjes publike	Informim/ ngjirje e vetëdijës	Takimi themelues i GKK (Prezantim dhe diskutim i formal)	03.02.2015 Qendra Inovative Gjakovë (IJC)	1/2 e ditës	DUMM/MP CHWB/KP	Shpenzimet e organizimit të takimit (salla e takimit, pilet...)	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Definimi i roleve dhe përgjegjësi të grupeve të involvuara në proces	Grupet e interesit në ÇeM, komuniteti, publiku i gjerë	- Vetëdijësimi lidhur me fillimin e hartimit të dokumentit - GKK i njoftuar me rezultatet e Punëtorisë 1 dhe konfirmimi i gëshjeve të ngritura	Informim/ ngjirje e vetëdijës	Ueb-faqja e komunës, mediat lokale	06.02.2015	N/A	Zyra komunale për informim	N/A	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Themelimi i GKK-së	Grupi këshillues i komunitetit (GKK)	Grupi këshillues i komunitetit (GKK)	Informim/ Konsultim	Shpërndarja elektronike në formë të shtypur raportit nga autoritetet lokale	01.03.2015	N/A	CHWB-KP OJQ	N/A	Projekti i CHWB/ Chemonics
PROFILI DHE ANALIZA E GIENDEJES EKZISTUESE	Punëtorja 1. Njohja me aktivitetet e projektit; afatet kohore dhe rezultatet e pritshme.	Grupet e interesit në ÇeM, komuniteti, publiku i gjerë	- GKK i njoftuar me rezultatet e Punëtorisë 1 dhe konfirmimi i gëshjeve të ngritura	Informim/ ngjirje e vetëdijës	Ueb-faqja e komunës, mediat lokale	06.02.2015	N/A	Zyra komunale për informim	N/A	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Diskutimi i nevojave, qëllimit dhe përbashkës së dokumentit / diskutimi i historisë dhe zhvillimit	Grupi këshillues i komunitetit (GKK)	- GKK i njoftuar me rezultatet e Punëtorisë 1 dhe konfirmimi i gëshjeve të ngritura	Informim/ Konsultim	Shpërndarja elektronike në formë të shtypur raportit nga autoritetet lokale	01.03.2015	N/A	CHWB-KP OJQ	N/A	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Punëtorja 2. SWOT	Grupi këshillues i komunitetit (GKK)	- GKK i njoftuar me rezultatet e Punëtorisë 1 dhe konfirmimi i gëshjeve të ngritura	Informim/ Konsultim / Ngjirje e vetëdijës	Ueb-faqja e komunës, mediat lokale	06.03.2015 Gjakovë (Hani Haraqës)	1/2 e ditës	DUMM/MP CHWB-KP	Shpenzimet e pritimit të draft PPP	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Analiza dhe interpretimi i të dhënave/identifikimi i gëshjeve kyçe	Komuna, Grupet e interesit: komuniteti i gjerë	Komuna, Grupet e interesit: komuniteti i gjerë	Konfirmimi dhe/ose marrje e komenteve për draft Komuniteti këshillues dhe veçorisht për aktivitetet pjesëmarrëse gjatë hartimit të dokumentit.	Informim/ ngjirje e vetëdijës/ Bashkëpunim / Ngjirje e vetëdijës	Postimi në Ueb-faqen e komunës dhe në shfaqjet e shtypura të shpërndarja e PPP	16-17.03.2015	2 ditë	CHWB; OJQ	Shpenzimet e organizimit të pritimit të PPP
VIZIONIMI	Punëtorja 3. Vizioni, Synimet kryesore	GKK, Grupit punues, GKK dhe Grupit punues për ÇeM	Dakordimi me vizionin dhe synimet për funksionalizimin e Çarshisë	Konsultim / Bashkëpunim / Ngjirje e vetëdijës	Punëtori	Java e 3-të e Marsit 2015	1 ditë	DUMM/MP CHWB-KP	Materialet e punës për punëtori Shpenzimet e organizimit të	Projekti i Chem onics
	Punëtorja 4. Përcaktimi i objekteve; Identifikimi i nevojave /masave dhe veprimeve / projekteve	Grupet e interesit në ÇeM, komuniteti dhe publiku i gjerë	Vetëdijësimi lidhur me zhvillimin e procesit të hartimit të dokumentit për Çarshinë	Informim/ Ngjirje e vetëdijës	Ueb-faqja e komunës, mediat lokale	Java e 3-të e Marsit 2015	N/A	Zyra komunale për informim	N/A	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Punëtorja 5. Prioritetet, resurset dhe afatet	Grupi këshillues i komunitetit	GKK i informuar me rezultatet nga Punëtorja 4 dhe konfirmimi i gëshjeve të ngritura	Konsultim / Konsultim	Takimi i GKK (Prezantim dhe diskutim)	Java e 2-të e Prillit 2015	1/2 e ditës	DUMM/MP CHWB-KP	Shpenzimet e organizimit të afatit	Projekti i CHWB/ Chemonics
FINALIZIMI I DOKUMENTIT	Prezantimi i draft dokumentit	GKK, Grupi Punues për Çarshinë e Madhe	Diskutimi dhe përcaktimi i prioritetëve, resurseve dhe afateve	Konsultim / Bashkëpunim	Punëtori	Java e 1-të e Majit 2015	1 ditë	DUMM/MP CHWB-KP	Shpenzimet e organizimit të afatit	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Proçesimi i dokumentit me rekomandime eventuale	Grupet e interesit në ÇeM, komuniteti dhe publiku i gjerë	Draft dokumenti i shqyrtuar nga GKK dhe Grupi Punues për Çarshinë e Madhe	Informim/ Konsultim	Shpërndarja elektronike dhe në formë të shtypur e draft-dokumentit	Java e 2-të e Majit 2015	5 ditë	DUMM/MP CHWB-KP OJQ	Shpenzimet e pritimit	Projekti i CHWB/ Chemonics
	Finalizimi i dokumentit	Grupet e interesit në ÇeM, komuniteti dhe publiku i gjerë	Publiku i njoftuar me qëllimin dhe përmbajtjen e dokumentit	Informim / Ngjirje e vetëdijës	Takim publik	Java e 3-të e Majit 2015	1/2 e ditës	DUMM/MP CHWB-KP për informim	N/A	Projekti i CHWB/ Chemonics
		Grupet e interesit në ÇeM, komuniteti dhe publiku i gjerë	Publiku i njoftuar me qëllimin dhe përmbajtjen e dokumentit	Informim / Ngjirje e vetëdijës	Ueb-faqja e komunës, mediat lokale	Java e 3-të e Majit 2015	- N/A - 5 ditë - 1 orë	DUMM/MP CHWB-KP OJQ	Shpenzimet e dizajnit dhe pritimit të fletëpalosjes	Projekti i CHWB/ Chemonics

3.5. Hapi 5: Zbatimi i Planit të Pjesëmarrjes së Publikut

3.5.1. Nivelet dhe teknikat e pjesëmarrjes publike

Gjatë hartimit të PPP, zbatimi i aktiviteteve të pjesëmarrjes së publikut në planifikim hapësinor, duhet të përcaktojë qartë nivelet e pjesëmarrjes publike dhe të propozojë teknikat dhe metodat e duhura.

Niveli i pjesëmarrjes publike do të përcakton aktivitetet dhe teknikat e përdorura gjatë procesit. Po ashtu do të ndikojë në kohën dhe resurset e nevojshme, si dhe përfitimet e arritura nga plani i përfshirjes së publikut.

Niveli i pjesëmarrjes publike gjithashtu përcakton se sa mundësi do të ketë publiku për të kontribuar në procesin e hartimit dhe rezultatet e tij. Për shembull, ai përcakton a do të kenë mundësi palët e interesit të punojnë bashkë me autoritetin komunal përgjegjës për planifikim hapësinor në kuadër të komitetit këshilldhënës për të dhënë rekomandime, apo do të kenë mundësi vetëm të japin komente gjatë prezantimit final të shqyrtimit publik.

Niveli i pjesëmarrjes së publikut përcaktohet në varësi të qëllimit të pjesëmarrjes në secilën nga fazat e planifikimit hapësinor ose zhvillimeve e propozuara me plan, duke filluar nga niveli më i ulët i pjesëmarrjes (informimi, konsultimi) deri te niveli më i lartë i pjesëmarrjes (dialogu, partneriteti dhe fuqizimi).

Element kyç i pjesëmarrjes domethënëse të publikut është përcaktimi i “niveleve të duhura të pjesëmarrjes”. Proces i pjesëmarrjes publike duhet të sigurojë nivele të pjesëmarrjes që korrespondojnë me nivelet e interesit publik në dokumentin përkatës të planifikimit hapësinor.

“Informimi” është hapi minimal që një Komunë duhet ta bëjë në mënyrë që të sigurohet për ndonjë veprim të suksesshëm, qofshin ato veprime të planifikimit apo tjera. Në këtë nivel, pjesëmarrja e publikut është e kufizuar në marrjen e informatës.

Me ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes në nivelin e “Konsultimit”, roli i publikut nuk është më pasiv. Në këtë nivel përfaqësuesit e institucioneve përveç që e “informojnë” publikun, kërkojnë dhe mbledhin reagime /mendime nga publiku përmes organizimit të takimeve, diskutimeve dhe hulumtimeve në terren.

Në nivelet më të larta të pjesëmarrjes “Dialogu” dhe “Partneriteti” publiku është pjesë aktive e procesit duke marrë pjesë në identifikimin e alternativave dhe formulimin e zgjidhjeve. Përfundimisht, në rastet kur arrihet niveli më i lartë i pjesëmarrjes “Fuqizimi” publiku e ka fuqinë të merr vendime për zgjidhjet dhe zbatimin e tyre.

Siç është përshkruar më poshtë, secili nivel i pjesëmarrjes së publikut ka një rritje përkatëse të nivelit të mundësive për kontributin publik për të ndikuar në procesin e planifikimit hapësinor.




Figura 1: Nivelet e pjesëmarrjes

Për zbatimin e aktiviteteve të PPP mund të përdoren një mori metodash/teknikash të pjesëmarrjes. Ato mund të përdoren si të veçanta apo edhe në kombinim me njëra-tjetrën. Përzgjedhja e tyre varet nga niveli i pjesëmarrjes, gjithmonë duke pasur parasysh që teknikat e përdorura të jenë të orientuara në drejtim të arritjes së qëllimeve të pjesëmarrjes publike. Shif shembujt e dhënë në tabelën 2, 3 dhe 4 lidhur me nivelet dhe teknikat e pjesëmarrjes në dokumentet e planifikimit hapësinor.

Suksesi i zbatimit të PPP ka të bëjë edhe me njohuritë dhe aftësitë që personat/grupi që udhëheq procesin duhet ta kenë në përdorimin e teknikave të duhura të pjesëmarrjes. Kjo para së gjithash i referohet stafit përgjegjës të komunës, kompanive hartuese të planeve apo/dhe organizatave që janë angazhuar për facilitimin e procesit të pjesëmarrjes së publikut.

3.5.1.1. Informimi

Informimi është nivel i pjesëmarrjes publike i cili ka për qëllim ta mbajë publikun të informuar lidhur me statusin e dokumentit të planifikimit hapësinor. Ka të bëjë me përcjelljen njëdrejtimëshe të informatës nga autoritetet lokale tek publiku. Autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor aplikon këtë nivel të pjesëmarrjes publike edhe për vetëdijesimin publik mbi një çështje të caktuar të planifikimit hapësinor.



Qëllimet në nivelin e "Informimit" mund të sillen prej ofrimit të informatave palëve të përzgjedhura të interesit bazuar në kërkesat e tyre, ose në baza të rregullta duke i bërë informatat e qasshme për publikun e gjërë, për të ngritur vetëdijen për procesin e planifikimit, çështjet e ngritura, alternativat dhe zgjidhjet e ofruara përmes dokumenteve të planifikimit.

Nuk do të jetë e mundur për publikun për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote pa e siguruar shpërndarjen e informacionit në mënyrë adekuate; prandaj niveli i informimit mbështet çdo hap tjetër në procesin e pjesëmarrjes së publikut.

Është me rëndësi ofrimi i informatave në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe klasifikimit të tyre sipas: gjinisë, racës, moshës, etnitetit, aspekteve të gjendjes sociale të komunitetit etj.

Në veçanti është me rëndësi që informata të jetë e qartë dhe e shprehur në gjuhë lehtë të kuptueshme për qytetarët, të jetë e bazuar në fakte dhe të ofrojë të dhëna të balancuara dhe objektive.

Këshilla të përgjithshme

- Përcaktoni qartë se cilat janë palët e interesit tek të cilat dëshironi ta përcjellin informatën dhe cila është mënyra më e lehtë që ata ti qasen asaj.
- Informatat e ofruara duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme për publikun e synuar.
- Informata duhet të jetë e kualitetit të lartë, konsistent dhe në kohë.

Për nivelin e pjesëmarrjes Informimi teknikat dhe metodat më të përdorshme janë: Lajmërimet ose njohtimet publike të cilat mund të jenë në formë të publikimeve, deklaratave për shtyp, broshurave, fletëpalosjeve të përgaditura për faza të ndryshme të procesit të planifikimit, posterat, dërgimi i sms-ave, shpalljet publike në ueb-faqe të komunës dhe në media të shkruara dhe elektronike, rrjete sociale, si dhe ekspozimi publik i planeve gjatë fazës së shqyrtimit publik etj.

Sipas legjislacionit në fuqi, Autoriteti komunal përgjegjës për planifikim hapësinor është i obliguar që të informojë me kohë publikun për aktivitetet gjatë procesit të planifikimit hapësinor (p.sh si për prezantimet, diskutimet publike gjatë çdo faze të planifikimit), dhe së paku tetë ditë para hapjes së shqyrtimit publik për planet hapësinore. Gjithashtu njohtimi publik duhet të publikohet në së paku tri gazeta ditore, televizionet publike dhe private si dhe në ueb-faqen e komunës.

Praktika të aplikimit të teknikave të ndryshme të informimit të publikut gjatë proceseve të planifikimit në komunat e Kosovës janë ilustruar më poshtë.



Foto 10. Komuna përmes faqes së interneti informon qytetarët mbi rezultatet e aktiviteteve të pjesëmarrjes së palëve të interesit në hartimin e Kornizës së funksionalizimit të Çarshisë së Madhe në qytetin e Gjakovës

Debat me qytetarë - 09 korrik 2015
Drejtorati i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM) në bashkëpunim me organizatën jo-qeveritare Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB) ka kënaqësinë t'ju tojë të jeni pjesë e takimit për diskutimin e skenarëve zhvillimore në kuadër të procesit të revidimit të PZHK (Planit Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë).

DUMM është i përkushtuar të bashkëpunoj ngushtë me të gjitha palët e interesuara gjatë procesit të revidimit të PZHK-së, duke synuar që ky bashkëpunim të reflektot në dokumentin e planifikimit hapësinor - PZHK. Përfshirja e qytetarëve në këtë proces është duke u mbështetur nga CHWB përmes projektit "Promovimi i pjesëmarrjes aktive në planifikim hapësinor në nivelin lokal", që financohet nga projekti "Partneriteti për Zhvillim" i USAID.

Qëllimi i këtij takimi është që në kuadër të përcaktimit të koncepteve zhvillimore (si fazë e hartimit/revidimit të PZHK) të diskutohen skenariot zhvillimore për të konkluduar, në fund të takimit, me propozimin e skenarior më të pranueshem nga të gjithë.

Pjesëmarrja e juaj në këtë takim publik do t'ju mundësojë që të jeni aktiv në shprehjen e mendimeve dhe komenteve në skenariot zhvillimore duke ndikuar drejtpërsëdrejti në planifikim hapësinor dhe kontribuar në përmirësimin e jetesës në komunën tuaj.

Lokacioni: Kuvendi Komunal Vushtrri

Data: 15.07.2015 (e mërkurë)

Koha: 11:00 - 13:30

Agjenda për takimit:

11:00 - 11:15 Hyrja dhe qëllimi i takimit (DUMM)

11:15 - 12:00 Prezantim: Skenariot Zhvillimore - InTech

12:00 - 13:00 Diskutim/Komentim

13:00 Përmbyllja e takimit



Foto 11. Komuna e Vushtrrisë përmes njohtimit publik dhe faqes së internetit informon dhe fton qytetarët për pjesëmarrje në debat për temë të caktuar të PZHK-së.



Foto 12: Kryetari i komunës së Pejës përmes postimit në facebook informon dhe fton qytetarët të marrin pjesë në aktivitetet e planifikimit hapësinor që komuna është duke ndërmarrë



Foto 13. Mediat e ndryshme (televizive lokale dhe nacionale) si dhe ato të shkruara informojnë publikun e gjerë mbi aktivitetet e planifikimit hapësinor në komunë.



3.5.1.2. Konsultimi



Konsultimi është mënyrë e mbledhjes dhe analizimit të reagimeve nga publiku i cili duhet të merret në konsideratë gjatë vendimmarrjes. Kjo mënyrë e komunikimit përdoret atëherë kur autoritetet komunale duan të marrin komente, kontribut apo sugjerime nga grupet e ndryshme të interesit përfshirë komunitetin në lidhje me planet hapësinore në komunë, zhvillimet e caktuara që ndërliken me këtë

fushë veprimtari, apo të nxisin debate publike lidhur me ndryshimet në plane apo proceset zhvillimore të planifikimit hapësinor pasi të ketë përfunduar konsultimi. Iniciativa dhe definimi i temës burojnë nga autoritetet komunale e jo nga grupet e interesit/përfaqësuesit të shoqërisë civile apo komunitetit.

Konsultimi i publikut mund të jetë: Formativ ose Verifikues. Kjo varet nga faza e zhvillimit të dokumenteve apo aktiviteteve të planifikimit hapësinor në komunë.

Konsultim Formativ quhet konsultimi i publikut i cili zhvillohet në fazat e hershme të procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit si p.sh të PZHK, HZK apo PRRH. Ky lloj konsultimi që zakonisht është në formën e intervistave dhe fokus grupeve (shih më gjerësisht në paragrafin lidhur me teknikat)përdoret për identifikimin e problemeve apo sfidave në planifikim hapësinor me të cilat ballafaqohen qytetarët, marrjen e ideve për trajtimin e problemeve, të kuptohen pasojat që mund të rrjedhin nga problemet e identifikuar etj. Meqenëse zhvillohet në fazat e hershme, ky lloj konsultimi ndikon në ngritjen e besimit mes qytetarëve dhe komunës duke i bërë qytetarët apo palët e interesit të ndihen pjesë e procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Konsultim Verifikues quhet konsultimi i publikut i cili zhvillohet në fazat e vonshme të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, dhe ka për qëllim verifikimin e zgjidhjeve/propozimeve/ projekteve të planeve të hartuara nga Autoriteti përgjegjës apo kompania kontraktuese. Përmes këtyre konsultimeve , qytetarët informohen për propozimet e planit dhe shprehin pikëpamjet/aspiratat apo shqetësimet e tyre lidhur me problemet eventuale apo efektet e padëshiruara që mund të gjenerohen gjatë zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Për autoritetet komunale kjo është me rëndësi pasi që përmes këtyre konsultimeve që zakonisht janë në formën e diskutime të hapura me grupet e interesit të vlerësojnë reagimin e publikut ndaj propozimeve të planit gjë që ju ndihmon në marrjen e vendimeve të duhura. Për publikun është shumë e rëndësishme që të informohet se si pikëpamjet e tyre kanë ndikuar në vendimet e marra në mënyrë që të marrin pronësi mbi këto vendime.

Këshilla të përgjithshme

- Bëni të qartë qëllimin e konsultimit dhe çfarë dëshironi të kuptoni nga publiku (marrja e komenteve për politikat ose planet, identifikimi i sfidave apo prioritetëve, përcaktimi i projekteve prioritare,...);
- Përcaktoni me kujdes grupet e komunitetit dhe palët e interesit që duhet konsultuar dhe përzgjidhni metodat më të përshtatshme për t'ju qasur atyre dhe për të marrë komente nga ata;
- Sigurohuni që publikut ti ofrohen informatat e duhura dhe koha e mjaftueshme për të shprehur pikëpamjet e tyre;
- Informoni publikun për rezultatet e konsultimeve. Shpjegoni si janë reflektuar pikëpamjet e publikut në vendimet e marra dhe jepni arsyet në rastet kur ato nuk janë marrë parasysh;
- Prezantoni informatat në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për publikun.

Për nivelin e pjesëmarrjes Konsultimi, teknikat dhe metodat që zakonisht përdoren janë :

- Anketimi është një metodë kërkimore për mbledhjen e informatave, e dobishme në rastet kur autoriteti komunal mbledh të dhëna, i analizon ato dhe i bën publike rezultatet. anketimet përdoren për të zbuluar faktet dhe opinionet e një grupi të madh siç është e gjithë popullsia e një komune, apo një grup i rëndësishëm i popullsisë. Anketimi mund të kryhet përmes pyetësorëve të standardizuar ose intervistave:

- intervistat ballë-për-ballë
- intervistat telefonike
- pyetësorët në letër
- pyetësorët “online” përmes internetit
- kombinim i këtyre metodave

Përderisa shumë njerëz e konsiderojnë pyetësorin si “anketim”, pyetësori është vetëm një pjesë e procesit të anketimit.

- Intervistat dhe pyetësorët janë teknika të cilat përdoren për të identifikuar problemet dhe për të marrë drejtpërdrejt mendimin e komunitetit në aspektin e proceseve të planifikimit hapësinor në lagjen / vendbanim dhe komunën e tyre. Këto teknika nuk përdoren vetëm për të gjeneruar të dhëna, por në të njëjtën kohë, për të siguruar informata të besueshme dhe cilësore lidhur me kushtet ekzistuese në komunitet, adresimin e nevojave të tyre dhe prioritizimin e çështjeve. Për më shumë informata mbi intervistimin dhe pyetësorin referojuni Shtojcës 3 dhe Shtojcës 4.

- Takimet publike me qytetarë - janë forumi më fleksibil dhe joformal për shkëmbimin e informatave ndërmjet autoriteteve komunale dhe qytetarëve të një lagjeje

ose vendbanimi përkatës. Kjo teknikë përdoret në rastet kur autoritetet komunale duan të diskutojnë një problem dhe zgjidhjet e mundshme me qytetarë, t'i informojnë ata në lidhje me propozimin e planit dhe për të ju ofruar atyre mundësinë për diskutim dhe shkëmbim të pikëpamjeve, për të shpjeguar opsionet dhe për tu përgjigjur pyetjeve për planet etj. Takimet publike inkurajohen si mundësi për komunikim joformal në mes të autoritetit dhe banorëve të cilët mund të preken nga propozimet e zhvillimit të komunës. Edhe pse të gjitha çështje nuk mund të zgjidhen, këto takime lejojnë kontributin e hershëm të qytetarëve dhe diskutimin.

Takimi publik mund të jetë mjaft i vogël, si p.sh. një zyrtar komunal dhe vetëm disa qytetarë, ose mjaft i madh me dhjetra ose qindra qytetarëve. Takimet publike sigurojnë një mundësi për pjesëmarrje dhe konsultim me qytetarët të cilët nuk janë pjesë e ndonjë organizate të shoqërisë civile dhe shpesh janë lënë jashtë procesit formal të konsultimit. Kjo mund të përfshijë përfaqësues të lagjeve të këshillave të fshatit, qytetarët e një lagje etj

Këto takime duhet të organizohen mirë dhe të udhëhiqen me kujdes.

Këshilla praktike:

Për të pasur një takim publik të suksesshëm me banorët e lagjes veproni si në vijim:

- a) Identifikoni një ose më shumë udhëheqës të diskutimit që do të drejtojnë diskutimin në një mënyrë lehtësuese dhe pozitive, ashtuqë të gjitha komentet të dëgjohen, pranohen, dhe të jipen përgjigje meritore në mënyrë që asnjë person mos të dominon apo tërheq diskutimin në një drejtim negativ. Duhet të jeni të përgatitur që njerëzit do të kenë ankesa dhe se jo çdo koment do të jetë pozitiv, por udhëheqësi i diskutimit duhet ti pranojë edhe komentet negative dhe të përpiqet të ndihmon gjetjen e një mënyrë për të udhëhequr grupin në punën e tij për të zgjidhur problemin dhe për të siguruar që diskutimi të mbetet produktiv.
- b) Gjatë takimeve publike të ftuarve duhet të ju sigurohen informata paraprake lidhur me çështjen e cila do të diskutohet. Mund të jetë e vështirë të shpërndahen informata të detajuara, mirëpo duhet bërë përpjekje për përgaditjen e një përmbledhje të shkurtër të informatave kyçe, të cilat pastaj mund të përshkruhen më në detaje përmes mediave, në Facebook, postera, etj.
- c) Përgatitni një prezantim të detajuar për çështjen në aspekt jo-teknik.
- d) Bëhuni fleksibil gjatë rrjedhës së takimit, përshtateni agjendën nëse është e nevojshme.
- e) Shpjegoni pjesëmarrësve në mënyrë të qartë qëllimin e takimit.
- f) Sigurohuni që dikush të regjistron komentet nga publiku.

Burimi: Marrë dhe përshtatur nga "Udhëzues për procesin e konsultimeve publike", Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit (2011) dhe plotësuar nga praktikantët e projektit: "Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal".

- Fokus grupet përfshijnë numër të vogël të pjesëmarrësve dhe përdoren për të kuptuar në thelb shqetësimet, përvojat apo qëndrimet në lidhje me një çështje ose problem të përcaktuar qartë të planifikimit, ose për të testuar propozimet dhe zgjidhjet. Fokus grupet janë mënyrë e thjeshtë dhe e shpejtë për të marrë pikëpamjet e ndryshme mbi një temë të veçantë diskutimit. Ato duhet të fasilitohen nga një fasilitues i trajnuar. Fokus grupet nuk janë takime të hapura; vetëm qytetarët e ftuar mund të marrin pjesë. Përbërja e grupit dhe diskutimi në grup planifikohen me kujdes për të krijuar një mjedis jo-armiqësor në të cilën njerëzit janë të lirë të flasin hapur. Meqenëse fokus grupet janë të strukturuar dhe drejtuara, por edhe ekspresive, ato mund të japin një shumë informata në një kohë relativisht të shkurtër. Më shumë informata lidhur me fokus-grupet mund janë dhënë në shtojcën 4.

Sipas legjislacionit të planifikimit hapësinor në fuqi, teknikat obligative të konsultimit të publikut janë:

- Diskutimi publik i cili sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 05 / 2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit hapësinor dhe parimeve dhe procedurave për pjesëmarrje publike në planifikim hapësinor është definuar si diskutim, konsultim, ose debat i lirë dhe i hapur me publikun dhe hisedarët tjerë, i organizuar nga autoritetet e planifikimit hapësinor gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Sipas UA, autoritetet komunale përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor janë të obliguara që të organizojnë së paku nga një diskutim publik në secilën fazë të hartimit të planeve hapësinore. Këto diskutime duhet të sjellin së bashku të gjitha palët e interesuara dhe relevante (qytetarët, sektorin publik dhe privat, OJQ, ekspertët etj). Autoriteti komunal duhet të bëjë njoftim publik së paku 8 ditë para diskutimit publik (përmes ëeb-faqes, njoftimit të publikut përmes mediave publike dhe private, etj.) dhe do të shqyrton vërejtjet e bëra gjatë këtyre diskutimeve dhe do të analizon përfshirjen e tyre të mundshme në planin hapësinor.

Gjatë procesit të hartimit të planeve, kjo teknikë përdoret për të mbledhur informata dhe reagime në secilën fazë të dokumenteve të planifikimit nga ekspertët dhe publiku i gjërë.

Këshilla praktike

Gjatë organizimit të një diskutimi publik nevojitet përgatitje e kujdesshme.

- Mos e ndërmerrni një diskutim publik nëse nuk jeni të përgatitur të përdorni rezultatet. Nëse qytetarët mendojnë se asgjë nuk ka rezultuar nga kontributi i tyre, kjo do të dëmtojë seriozisht diskutimin e ardhshëm publik;
- Jini plotësisht të qartë lidhur me qëllimin e diskutimit publik. Çfarë duhet të komunikohet publikut? Çfarë informata kërkohen nga publiku? Si duhet të përdoren informatat e mbledhura? Shpjegon imirë këto në fillim dhe në menyrë të qartë.
- Vetëm njoftimi për diskutim publik nuk mjafton që njerëzit të marrin pjesë. Duhet shfrytëzuar në mënyrë efektive mediat, edukimi publik, rrjetet e shërbimeve publike si shkollat ose marketet e frekuentuara, dhe rrjetëzimi i autoriteteteve komunale me miqtë dhe fqinjët e tyre (edhe zyrtarët janë qytetarë!).
- Diskutimi publik zakonisht duhet ta hapet nga ndonjë zyrtar komunal mirëpo udheheqja e takimit duhet të bëhet nga një fasilitues i shkathtë dhe i mirëinformuar. Kjo qasje përcjell sinjale të dyfishta te qytetarët se çështja është e rëndësishme dhe se autoritetet komunale po i dëgjojnë pikpamjet e tyre. Përdorimi i fasilituesit gjithashtu siguron që agjenda do të respektohet në maksimum dhe se folësit do të ndjehen të lirë të shprehin mendimet e tyre.
- Përcjellni rezultatet. Qytetarët e shohin diskutimin publik vetëm si një hap gjatë procesit. Kjo është ajo që është. Sigurohuni ti përcjellni informatat kthyes nga takimi përmes mediave dhe postimit publik të rezultateve. Ato duhet të përmbajnë edhe përgjigjet në pyetjet e ngritura si dhe njoftimi i qytetarëve se si do të përdoren rezultatet e takimit gjatë procesit të vendimmarrjes.

Burimi: *Marrë dhe përshtatur nga RTI: Udhëzues Praktik për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Qeverisjen Vendore*

- Shqyrtimi publik sipas përcaktimit të Ligjit për Planifikim Hapësinor është një ngjarje që është e hapur për pjesëmarrjen e publikut, e zhvilluar në vende të përshtatshme nga autoriteti planifikimit hapësinor, i cili me anë të një njoftimit publik fton qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara të ngrisin kundërshtimet, komentet apo sugjerimet e tyre para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapësinor.

Karakteristikë thelbësore është se ai siguron një mundësi për autoritetet komunale për të dëgjuar dhe për të kuptuar pikëpamjet e qytetarëve para se të mirret një vendim përfundimtar. Idealisht ky duhet të jetë kulmi i një procesi të planifikimit, përgatitjes dhe konsultimit të publikut që ka përfshirë një fushatë të vazhdueshme të informimit publik, takime publike dhe mënyra të tjera për të marrë pikëpamjet publike.

Kërkesa ligjore për periudhën për shqyrtim publik në një draft- dokument të planifikimit hapësinor është të paktën 30 ditë; kurse Shqyrtimi publik i ndryshimeve në draft zgjat të paktën 15 por jo më shumë se 30 ditë. Gjatë kësaj periudhe një sërë aktivitetesh për konsultim publik duhet të zhvillohen dhe të përfshijnë:

- Njoftimin dhe informimin e qytetarëve: Është kërkesë ligjore që Autoriteti Planifikimit Hapësinor Komunal bën njoftimin për shqyrtimin publik të draft-dokumentit të planifikimit të paktën në tri gazeta të përditshme, në ueb-faqen e vet, kanalet e mediave publike dhe private. Përveç kësaj, autoriteti komunal mund të përdorë forma tjera të informimit publik si postera, tabelat e shpalljeve, kiosku i informimit, rrjetet sociale, etj. Shpallja publike duhet të bëhet 8 ditë para shqyrtimit publik. Komuna duhet të sigurohet që të përfshijë në njoftim: Vendin, datën, kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen e shqyrtimit publik; vendin dhe kohën e prezantimeve publike shtesë, llojin e dokumenteve të planifikimit që do të shqyrtohet nga publiku; japin informacion si është i qasshëm draft-dokumenti; informacionin e kontaktit, etj.
- Ceremonia e hapjes së shqyrtimit publik: Kjo është ngjarja e parë publike që shënon hapjen e shqyrtimit publik. Në praktikën e Kosovës, kjo ngjarje është hapur zakonisht nga kryetari i komunës dhe është lehtësuar (fasilituar) nga drejtori i departamentit të planifikimit apo zyrtari komunal i planifikimit i cili ishte përgjegjës për menaxhimin e procesit të planifikimit. Ngjarja është e hapur për publikun në përgjithësi dhe të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë zyrtarë qeveritarë nga niveli qendror dhe lokal, përfaqësues të ndërmarrjeve publike, sektorit privat, komunitetit të biznesit, agjencive donatore, përfaqësues të organizatave joqeveritare etj. Pas fjalimeve hyrëse, bëhet një prezantim mbi përmbajtjen e dokumentit të planifikimit. Më pas, një kohë i përkushtohet pyetjeve të bëra nga audienca publike dhe përgjigjeve nga zyrtarët përgjegjës komunalë. Kur koha për komente publike ka kaluar, zyrtarët falënderojnë qytetarët për pjesëmarrjen e tyre dhe i informojnë ata lidhur me aktivitetet e ardhshme gjatë shqyrtimit publik dhe i fton qytetarët që të japin komente në librin e vërejtjeve të vënë në dispozicion në këtë ngjarje. Gjatë kësaj ngjarjeje hartat e dokumentit të planifikimit janë të ekspozuara në mure dhe draft-dokumenti është në dispozicion për publikun në formë të shtypur apo elektronike. Për arsye praktike dhe duke pasur parasysh se dokumentet e tilla janë voluminoze dhe të shkruara në gjuhën teknike, rekomandimi është që të përgatitet një version i shkurtër i draft-dokumentit të planifikimit për përdorim publik. Këto duhet të shkruhen në gjuhë të lehtë dhe të kuptueshme për publikun, të jenë ilustruar mirë dhe të ofohen në një format të shtypur.
- Ekspozimi i dokumentit të planifikimit: Gjatë periudhës prej 30 ditësh, draft-dokumenti ekspozohet në publik për t'u komentuar. Ky aktivitet ka nevojë të

menaxhohet dhe kërkon burime njerëzore nga komuna që të jenë në dispozicionë mënyrë të vazhdueshme për të siguruar shpjegime për publikun për përmbajtjen e planit.

Vërejtjet nga publiku duhet të ofrohen në formë të shkruar, ose si peticion i bërë nga grupet e pakënaqura të komunitetit të cilët konsiderojnë se është bërë një shkelje e ligjit apo interesit të tyre në dokumentin e planifikimit.

Të gjitha vërejtjet duhet të regjistrohen në librin e vërejtjeve. Duhet të sigurohet marrja në mënyrë të saktë e detajeve të kontaktit të atyre që kanë bërë vërejtje.

Është gjithashtu e rëndësishme të sigurohen vende të përshtatshme për ekspozimin e dokumenteve të planifikimit të cilat do të mundësonin qasjen e lehtë për gjithë qytetarët me kujdes të veçantë ndaj të moshuarve dhe personave me nevoja të veçanta.

- **Prezantimet publike të draft-dokumentit të planifikimit:** Gjatë shqyrtimit publik, autoriteti i planifikimit hapësinor organizon një sërë prezantimesh publike me qëllim të qartësimit të arsyeshmërisë së zgjidhjeve përkatëse të dokumentit të planifikimit. Prezantime publike do të bëhen dhe përgatiten posaçërisht për pjesëmarrë të ndryshëm. Kjo mund të përfshijë për shembull prezantimin publik të draft-dokumentit të planifikimit në disa zona rurale apo lagje të qytetit, prandaj është e rëndësishme që ngjarje të tilla të organizohen në zonën e afërt gjeografike të këtyre grupeve të synuara. Procesverbali duhet të mbahet, dhe vërejtjet duhet të regjistrohen.

- **Analiza e komenteve dhe reagimeve:** Në fund të shqyrtimit publik, të gjitha komentet e publikut, propozimet dhe vërejtjet në draft-dokumentin e planifikimit të paraqitura brenda mënyrës dhe afatit kohor të përcaktuar nga legjislacioni janë të regjistruara dhe të përfshira në raportin e shqyrtimit publik. Raportitit i bashkangjien edhe procesverbalet e prezantimeve dhe diskutimeve të mbajtura gjatë shqyrtimit publik.

Autoriteti komunal i planifikimit hapësinor i analizon me kujdes veç e veç secilën vërejtje dhe e përgatit arsyeshmërinë lidhur me pranimin ose refuzimin e përfshirjes së tyre në plan.

Kohëzgjatja e përgatitjes së raportit është jo më shumë se 30 ditë për draft-dokumentin e planifikimit dhe 15 ditë për ndryshime të në draft-dokument, prej ditës së dorëzimit të vërejtjeve dhe propozimeve në formë të shkruar. Raporti i shqyrtimit publik publikohet në ueb-faqen komunale, pesë ditë pas shqyrtimit të vërejtjeve.

Gjatë procesit të marrjes së pëlqimit për dokumentin e planifikimit hapësinor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, raporti i shqyrtimit publik është gjithashtu pjesë e shqyrtimit.



Foto 14. Foto nga konsultimet me publikun rreth PRrU në komunën e Pejës (lart) dhe komunën e Prishtinës (poshtë)





Debati publik për Planin Zhvillimor dhe Urbanistik të Komunës së Vushtrrisë - 15 korrik 2015

Komuna e Vushtrrisë, përkatësisht Drejtorati i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM) në bashkëpunim me organizatën jo-qeveritare Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) ka mbajtur sot një takim me qytetarë dhe subjekte të ndryshme nga jeta ekonomike e shoqërore, ku është diskutuar lidhur me skenariot zhvillimore në kuadër të procesit të revidimit të PZHK(Planit Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë). Ky takim u mbajt nën drejtimin e Sami Istrefit,

drejtor i DUMM, kurse të pranishmit i përshëndeti edhe Dibran Përcuku, nënkryetar i Komunës, i cili u angazhua që pjesëmarrësit të jenë sa më aktiv në shprehjen e mendimeve dhe propozimeve që do të ndikojnë pozitivisht në hartimin e planit.

“Pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e këtij dokumenti ka rëndësi të veçantë që plani zhvillimor i komunës së Vushtrrisë të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve të saj. Për këtë qëllim kemi ftuar përfaqësuesit e partive politike, organizatat dhe shoqëritë jo qeveritare, profesorët dhe arsimtarët, njerëzit e biznesit, artistët, farmerët, sportistët, përfaqësuesit e shoqërive të grave si dhe të gjithë qytetarët e tjerë, që të japin kontributin e tyre në këtë drejtim”, ka thënë Istrefi. Kontribut për hartimin e planit hapësinor komunal, i cili i vërteton udhëzimet ekonomike të zhvillimit ekonomik, infrastrukturën, shfrytëzimin e tokës dhe mjedisit si dhe çështjet demografike dhe sociale të komunës së Vushtrrisë, përmes debatit kanë thënë edhe Remzije Zekolli, Dr. Luljeta Zahiti, Nezir Klinaku, Arq. Arsim Gërxhaliu, Shemsi Rahimi, e qytetarë tjerë. Ky projekt realizohet në kuadër të “Partneritetet për Zhvillim” që financohet nga USAID.

Foto 15: Komuna konsulton me qytetarët skenarët e zhvillimit hapësinor të Planit Zhvillimor Komunal-Vushtrri

3.5.1.3. Dialogu



Dialogu është nivel i pjesëmarrjes i cili ka për qëllim punën e drejtpërdrejtë të komunës me publikun për të siguruar që gjatë procesit të planifikimit hapësinor, në vazhdimësi janë kuptuar dhe janë marrë në konsideratë brengat dhe aspiratat e tyre. Përderisa gjatë ‘konsultimit’ nga publiku kërkohet mendimi lidhur me një çështje të caktuar në një moment të caktuar të procesit, ‘dialogu’

nënkupton një komunikim dy-drejtimësh në mes komunës dhe publikut gjatë gjithë procesit. Gjatë zhvillimit të këtij niveli të pjesëmarrjes duhet të bëhet e qartë për publikun se shqetësimet e tyre janë reflektuar drejtpërdrejt në alternativat dhe zgjidhjet e propozuara dhe se ato janë inkorporuar në procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, marrja e vendimeve përfundimtare mbetet tek autoritetet komunale dhe publikut nuk duhet dhënë shpresë për ndikim të drejtpërdrejtë mbi vendimet.

Këshilla të përgjithshme

- Sigurohuni që të jenë të përfshira të gjitha palët e rëndësishme të interesit;
- Ofroni mundësi të barabarta për pjesëmarrje për të gjithë (eliminoni barrierat e mundshme që mund të pamundësojnë përfshirjen e palëve në proces);
- Analizoni me kujdes se cilat aktivitete dhe struktura/trupa (borde këshilluese, fokus grupe, grupe teknike, etj) i përshtaten qëllimit të pjesëmarrjes dhe kush duhet të angazhohet (varësisht nga shkathtësia apo përfaqësimi);
- Konsideroni një gamë të gjerë të interesave, aspekte tw atilla që mund të jenë të rëndësishme për publikun si: ndotja, vlerat e pronës, trafiku ingjeshur, ekonomia lokale, etj;
- Përcaktoni qartë që në fillim të procesit rregullat e themelimit të këtyre trupave pjesëmarrës, mënyrën e punës dhe vendimmarrjes, dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre gjatë procesit.

Për nivelin e Dialogut, teknikat më të përdorshme të pjesëmarrjes publike janë:

- Forumet publike të komunitetit: Sigurojnë një mënyrë për dhënien e propozimeve nga ana e qytetarëve apo organizatat i që përfaqësojnë ata direkt tek autoritetet e planifikimit hapësinor komunal.
- Komitetet Këshilluese/Drejtuese: Janë një grup i mbledhur i palëve të interesit që përfaqësojnë komunitetin dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllimin për të kontribuar, ofruar reagime dhe udhëzime në proceset e planifikimit hapësinor. Në përgjithësi anëtarët e grupit emërohen nga

grupet përkatëse të komunitetit dhe agjencitë; edhe njerëzve me nevoja të veçanta mund t'ju kërkohet të marrin pjesë. Jetëgjatësia e Komiteteve Këshilluese/ Drejtuese zakonisht është e kufizuar në kohëzgjatjen e procesit të planifikimit të dokumentit të planifikimit që hartohet.

- Punëtoritë: Punëtoritë ju japin autoriteteve komunale mundësinë për të shpërndarë informacion, për të siguruar një mjedis për diskutim, dhe për të marrë reagime nga një gamë e grupeve të komunitetit dhe qytetarëve. Ata kanë karakter edukativ dhe përdoren për të orientuar pjesëmarrësit në çështjen e cila do të diskutohet. Ato zakonisht përfshijnë edhe diskutimin në grupe më të vogla në mes të pjesëmarrësve, në të cilat ata kanë mundësi të shprehin mendimet e tyre qoftë në formë të shkruar apo përmes bashkëbisedimit.
- Vizionimi: Është një teknikë e pjesëmarrjes publike e cila përdoret për të zhvilluar një skenar të preferuar të zhvillimit të ardhshëm afatgjatë hapësinor të komunës. Ushtrimi i Vizionimit përdoret rregullisht për planifikimin strategjik duke i mundësuar komunitetit të japë përcaktime për të ardhmen që e dëshiron. Vizionimi thekson vlerat e komunitetit dhe shpreh dëshirën e tyre për të ardhmen në formë të deklaratave dhe vizuale. Ushtrimi i vizionimit gjithashtu ofron një kornizë për një strategji dhe hapat që janë të nevojshme për të arritur këtë vizion.
- Sesionet e ndërmjetësimit: Në kontekstin e pjesëmarrjes publike është një metodë për angazhimin e një grupi të vogël të banorëve në një pikë kritike në procesin e planifikimit, atëherë kur interesat kontradiktore mund të ndikojnë negativisht në propozimet planifikimit. Sesionet e ndërmjetësimit janë një proces vullnetar në të cilin palët e përfshira bien dakord që të provojnë të zgjidhin mospajtimet e tyre. Meqenëse problemi shpesh mund të ndodhë si rezultat i keqinformimit, moskunikimit apo keqkuptimit, këto sesione mund të sjellin zgjidhje të mospajtimeve midis palëve të përfshira në konflikt.

3.5.1.4. Partneriteti dhe fuqizimi



Partneriteti është nivel i lartë i përfshirjes së publikut në proceset e planifikimit hapësinor i cili mund të nënkuptojë edhe delegimin e përgjegjësive të caktuara në këtë fushë veprimtari tek përfaqësuesit e komunitetit.

Përmes negociimit, fuqia vendim-marrëse është e ndarë mes autoriteteve komunale dhe qytetarëve, megjithatë vendimmarrja përfundimtare mbetet mbi autoritetet komunale.

Procesi nënkupton partneritet me publikun në secilin ose ndonjë aspekt të caktuar të procesit të vendimmarrjes me qëllimin për të ndërtuar konsensus për alternativat e zhvillimit hapësinor dhe përzgjedhjen e zgjidhjes më të preferuar.

Gjatë këtij procesi kërkohet një nivel i lartë i besimit ndërmjet palëve, ndërsa bashkëpunimi mund të realizohet përmes krijimit të trupave formal bashkëpunues si bordet apo komisionet e ndryshme, ose edhe në mënyrë joformale.

Këshilla të përgjithshme:

- Duhet patur kujdes që të qartësohet mirë deri në çfarë mase shtrihet vendimmarrja që është deleguar dhe në veçanti, atë çfarë nuk përfshin ajo.
- Të gjithë partnerët e përfshirë në proces, duhet të bien dakord për një plan dhe rregulla bazike të qarta.
- Përcaktoni qartë kushtet e përfaqësimit në trupat si bordet apo komitetet bashkëpunuese, rolin dhe përgjegjësitë e tyre si dhe mënyrën e marrjes së vendimeve (me votim apo konsensus).
- Procesi duhet të synojë arritjen e konsensusit mes të partnerëve, ku idetë janë mbledhur dhe zgjidhjet janë të negociuara.
- Në rastet e vendosjes formale të partneritetit, duhet ti kushtohet kujdes marrëveshjeve të qeverisjes të cilat në mënyrë të qartë definojnë rolet dhe përgjegjësitë e partnerëve të përfshirë.

Fuqizimi konsiderohet niveli më i lartë i pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e planifikimit hapësinor, i cili në praktikë ndodh rrallë. Qëllimi i këtij niveli të pjesëmarrjes është vendosja e vendimmarrjes përfundimtare në duar të publikut, duke siguruar se autoritetet do të zbatojnë atë çfarë vendos publiku.

Në këtë rast, korniza ligjore dhe ajo e politikave i jep fuqi komunitetit për të marrë vendime të bazuara në fakte për të cilat ata mbajnë përgjegjësi dhe japin llogari për efektet e arritura nga zbatimi i tyre. Shtrirja e fuqisë vendimmarrëse të publikut mund të jetë e gjerë apo e kufizuar në kohë dhe një çështje të caktuar dhe vendimet përfundimtare mund të sillen përmes votimeve ose me konsensus. Për këtë nivel të pjesëmarrjes, është e rekomandueshme marrja e vendimeve përfundimtare me konsensus, pasi që votimi bazik në vetvete shpesh nuk arrin të krijojë nivelin e njohurive të publikut dhe kontributin e gamës së gjerë të publikut i cili është i nevojshëm për pjesëmarrjen kuptimplotë të publikut.

Edhe pse shumë sfidues për tu realizuar, fuqizimi si nivel i pjesëmarrjes mundëson ngritjen e kapaciteteve të publikut që ndikon në arritjen e rezultateve më të mira duke sjellë ide kreative dhe mundësi të reja.

Këshilla të përgjithshme:

- Duhet të ketë qartësi në lidhje me fushëveprimin e pushtetit të përbashkët dhe / ose vendim-marrjen e cila i është deleguar publikut.
- Duhet të ketë qartësi në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë. Fuqizimi i lejon qytetarët të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave, caktimin e prioriteteve, formulimi dhe zgjedhjen midis opsioneve, zhvillimin e strategjive për dokumentet e planifikimit hapësinor dhe zbatimin e tyre.
- Çështjet që përfshijnë llogaridhënien duhet të konsiderohen me kujdes. Publiku tani ka fuqinë për të siguruar përgjegjshmërinë e rezultateve të planifikimit për veten e tyre.
- Komunitetet duhet të posedojnë burime të mjaftueshme - kapacitetet njerëzore adekuate për të aplikuar këtë nivel të pjesëmarrjes. Kjo duhet të përfshijë individët kreativ dhe me mendësi qytetareske, jo vetëm publikun i përfaqësuar nga shoqatat dhe grupet e interesit.

Për të dy nivelet e pjesëmarrjes publike Partneritetit dhe Fuqizimin, teknikat që zakonisht përdoren më së shumti përfshijnë:

- Koalicionet dhe partneritetet: Proceset e planifikimit bashkëpunues kërkojnë pjesëmarrje të rregullt, konsistente dhe kontribut nga publiku, palët kryesore të interesit, partnerët dhe të tjerët. Për këtë qëllim mund të krijohen koalicione dhe partneritete të përbëra nga palët e interesit të ndryshëm. Ato ofrojnë udhëzime dhe reagime të nevojshme për autoritetin komunal ose konsulentët e përfshirë në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe sigurojnë kompletimin me sukses të tyre.
- Grupet Këshillimore të Komunitetit janë grup i palëve të interesit që përfaqësojnë komunitetin dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllimin për të ofruar kontribut, reagime, dhe angazhim të qytetarëve në proceset e planifikimit hapësinor. Ato janë një mekanizëm i rëndësishëm që vazhdimisht do të informojë autoritetet komunale për nevojat dhe kërkesat e publikut. Në nivelin e partneritetit të pjesëmarrjes publike, roli i Grupit është të përfshijë publikun në procesin e vendimmarrjes. Më shumë elaborim është dhënë në seksionin 3.3 të këtij udhëzuesi.
- Juria e Qytetarëve: Juritë e qytetarëve përfshijnë komunitetin më të gjerë në procesin e vendim- marrjes . Ajo përdor një përfaqësim të qytetarëve të zgjedhur zakonisht në një mënyrë të rastësishme të cilët formalisht nuk i përkasin kurrfarë grupi të interesit në mënyrë që të parandalojnë avokimin për ndonjë rezultat të veçantë të planifikimit. Atyre ju kërkohet të marrin në konsideratë çështje e cila ka efekt në të gjithë komunitetin dhe për të cilën është e nevojshme një proces I vendimmarrjes me përfaqësim dhe demokratike.

Shembull i modelit efektiv të dialogut dhe partneritetit ndërmjet komunës, komunitetit dhe palëve të interesit relevantë për çështjet e rigjenerimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë

Përfshirja aktive e GKK në zhvillimin e projektit ka forcuar bashkëpunimin mes komunës, komunitetit dhe aktorëve të tjerë relevant. Bazë e kësaj qasjeje ishte krijimi i marrëdhënieve të besueshme në mes të palëve përmes konsultimit dhe dialogut të vazhdueshëm në identifikimin e çështjeve dhe alternativave dhe partneritetit për të përcaktuar prioritetet dhe arritur objektivat. Krijimi i Njesisë për Menaxhimin e Çarshisë së Madhe është identifikuar si një objektiv kryesor që lidhet me rigjenerimin e Çarshisë së Madhe. Kjo njësi do të sigurojë koordinimin e të gjitha palëve të interesit të Çarshisë dhe do të jetë përgjegjëse për zbatimin e veprimeve të propozuara në “Kornizën e rigjenerimit të Çarshisë së Madhe”. Në bordin e Njesisë bashkë me zyrtarët komunal dhe ata të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-së do të jenë edhe përfaqësuesit e komunitetit të propozuar nga GKK. Megjithatë, Komuna duhet të tregojë zotim se propozimet e politikave të krijuara së bashku me qytetarët do të merren në konsideratë në marrjen e vendimit përfundimtar. Në këtë aspekt, ky propozim është diskutuar më tej me kryetaren e komunës dhe të gjitha arritën pajtueshmëri lidhur me strukturën dhe funksionimin e Njesisë në të ardhmen. Për më tepër, për të siguruar mbështetjen e vendimmarrësve, në mbledhjen e Kuvendit Komunal të mbajtur më 21 korrik 2015, propozimi për themelimin e Njesisë së Menaxhimit është diskutuar dhe miratuar me vetëm një votë kundër.

Burimi: Nga praktikat e projektit: “Promovimi i pjesëmarrjes aktive të publikut në planifikim hapësinor në nivelin lokal”

3.6. Hapi 6: Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të PPP në aktivitetet e planifikimit hapësinor

Hapi final në procesin e pjesëmarrjes së publikut është evaluimi i i efektivitetit të zbatimit të aktiviteteve të PPP. Evaluimi kërkon monitorim të rregullt dhe vlerësim nëse rezultatet e aktiviteteve të PPP kanë arritur qëllimet e pjesëmarrjes së publikut në çdo fazë të procesit të planifikimit. Në praktikë ky hap duket se gjithmonë trajtohet në fund të procesit të planifikimit me pjesëmarrje, megjithatë është e rëndësishme të theksohet se këto dy funksione janë parë si pjesë integrale e çdo faze të procesit të PPP. Qëllimi është të sigurohet se ekipet e planifikimit të mendojnë dhe veprojnë mbi çështjet e monitorimit dhe evaluimit që nga fillimi i procesit të hartimit të PPP.

Në rrjedhën e evaluimit dhe monitorimin e zbatimit të PPP për proceset e planifikimit hapësinor, vlerësimi duhet t’ju përgjigjet pyetjeve të mëposhtme :

- A është PPP për procesin e planifikimit duke i arritur qëllimet/ objektivat e tij të synuara?
- Procesi a i ka arritur njerëzit e duhur dhe bërë pyetjet e duhura?
- Njerëzit që janë përfshirë, a ndihen se zëri i tyre është dëgjuar?
- Përgjigjet a tregojnë mbi atë çfarë është dashur të dijmë?
- A ka qëndruar procesi përbrenda buxhetit dhe resurseve që kanë qenë në dispozicion?
- Nëse përdorimi i teknikave përkatëse të pjesëmarrjes publike ishte efektiv mjaftueshëm për të siguruar rezultatet e kërkuar?
- A janë identifikuar kufizimet dhe sfidat që e kanë penguar përfundimin e procesit sipas PPP gjatë procesit të pjesëmarrjes së publikut?
- Cilat janë mënyrat për përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut në proceset e planifikimit në të ardhmen?
- Si të përdoren mësimet e nxjerra nga procesi në iniciativat e ardhshme të pjesëmarrjes së publikut ?

Konsideratat e përmendura më lartë ofrojnë një bazë të mirë për të vlerësuar nëse zbatimi i PPP-së është në rrugë të mirë. Identifikimi i veprimeve që kanë penguar përfundimin e procesit sipas planit do të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve alternative bazuar në mësimet e nxjerra dhe në rafinimin e procesit.

Vlerësimi i PPP-së duhet të bazohet në:

- qëllimet / objektivat e PPP;
- monitorimin e progresit dhe rezultatet e matshme të PPP; dhe
- identifikimin e mësimet të nxjerra dhe përmirësimin e praktikave të ardhshme.

Duke qenë se angazhimi bëhet më i përhapur dhe në shkallë më të gjerë, ka nevojë për të vlerësuar efektivitetin e procesit të përfshirjes së publikut. Vlerësimi i PPP bëhet gjatë dhe pas zbatimit të PPP .

Teknikat që më së shpeshti përdoren në vlerësimin e zbatimit të PPP varen nga ajo se kur ndodh.

Nëse vlerësimi ndodh gjatë procesit të zbatimit të aktiviteteve të PPP, atëherë teknika më e shpeshtë është përdorimi i pyetësorëve për vlerësimin e çdo takimi të pjesëmarrjes apo përmes formës së diskutimit me pjesëmarrës. Përparësia këtu është se meqenëse ky lloj vlerësimi bëhet në vazhdimësi, ofron mundësi të mirë për përmirësimet eventuale në përdorimin e teknikave apo niveleve të pjesëmarrjes në aktivitetet e ardhshme. Vlerësimi në këtë fazë bëhet nga autoriteti përgjegjës për pjesëmarrjen e publikut.

Vlerësimi pas zbatimit të aktiviteteve të PPP duhet të jetë i harmonizuar me qëllimin specifik të vlerësimit dhe mund të përdoren një mori teknikash dhe

metodologjish si: anketimin dhe sondazhet e zhvilluara me qytetarët; përdorimin e regjistrave të pjesëmarrjes për të vlerësuar shkallën e pjesëmarrësve të pranishëm

Këshilla praktike

Për të vlerësuar se a kanë qenë adekuate teknikat dhe metodologjitë e pjesëmarrjes dhe për të marrë informatë kthyesë nga pjesëmarrësit, mund të përdoren teknikat si vijon:

- Pyetësorët e vlerësimit të cilët i shpërndani dhe merrni në pjesën e fundit të ngjarjes.
- Nga ana tjetër, mund të përdorni metodën e vlerësimit online përmes [surveymonkey.com](https://www.surveymonkey.com), Google Docs ose ndonjë platforme tjetër të hapur dhe dërgojani emailin me vegzën e pyetësorit pjesëmarrësve. Nëse përdorni ndonjë metodë on-line të vlerësimit, sigurohuni që të dërgoni pyetësorin në një afat sa më të shkurtër pas mbarimit të punëtorisë, në mënyrë që rezultatet të jenë sa më valide (detalet që juve ju interesojnë mund të zbehen nga kujtesa pas një kohe);
- Pyetësorët përgatitni të mbushen në mënyrë anonime;
- Përgatisni listat e pjesëmarrjes dhe mbani shënime për propozimet e publikut;
- Shkruani raporte pas aktiviteteteve, ku do t'i elaboroni edhe komentet/sugjerimet/propozimet e publikut si dhe rezultatet nga pyetësorët e vlerësimit.

në një aktivitet të pjesëmarrjes publike, % e pjesëmarrësve nga një lagje apo zonë e caktuar gjeografike si dhe për të dhënë vlerësim rreth gjithëpërfshirës së grupeve të ndryshme të interesit; përdorimin e raporteve dhe procesverbaleve nga secili aktivitet për të vlerësuar se sa ka pasur pjesëmarrje aktive gjatë takimeve publike, shikimit të shkarkimeve në faqen e internetit në lidhje me ndonjë informatë apo aktivitet që ka të bëjë me pjesëmarrjen publike në planifikim hapësinor dhe regjistrave në lidhje me numrin e informatorëve, fletushkave dhe materialeve tjera të shpërndara etj.

Përveç të kuptuarit se a kanë qenë të duhura teknikat dhe metodologjitë e pjesëmarrjes si dhe të merret informatë kthyesë nga pjesëmarrësit, vlerësimi në këtë fazë ka për qëllim edhe të kuptojë se aktivitetet e kryera të pjesëmarrjes së publikut a kanë arritur efektet e dëshiruara qoftë në raport me procesin e pjesëmarrjes publike gjithashtu edhe në raport me efektet në zhvillimet hapësinore në lagjen/vendbanimin/komunën e tyre. Prandaj ky vlerësim zhvillohet pas një periudhe të caktuar kohore, e cila duhet të jetë e mjaftueshme për të treguar efektet nga aktivitetet e PPP. Ky vlerësim duhet të jetë i paanshëm prandaj është e rekomandueshme të kryhet nga vlerësues të jashtëm (persona që s'kanë qenë pjesë e procesit të PPP).

Me qëllim të sigurimit të transparencës, një rekomandim i përgjithshëm është që rezultatet nga këto vlerësime të bëhen të ditura për publikun.

Përfitimet që ju sjell autoriteteve komunale procesi i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të aktiviteteve të PPP gjatë proceseve të planifikimit hapësor janë:

- Shohin nëse aktivitetet e tyre janë të suksesshme: A janë mjetet efektive? A është kontaktuar publiku? A ishin resurset adekuate? A janë arritur qëllimet e pjesëmarrjes publike?
- Demonstrim të tjerëve se aktivitetet ishin të suksesshme: Kjo është e rëndësishme në arsyetimin e planifikimit dhe aktiviteteve.
- Mësim nga praktika: Vlerësimi dhe shpërndarja e rezultateve i mundëson autoriteteve publike të mësojnë prej aktiviteteve të veta dhe vendosjen e praktikave më të mira të cilat mund të përdoren në të ardhmen.
- Ridizajnim i aktiviteteve dhe krijim i aktiviteteve të reja: Kjo arrihet duke u bazuar në mësimet e nxjerra dhe përvojat siç shpjegohet në a, b, c duke rritur mundësinë e suksesit në të ardhmen si dhe ndërtimin e kapaciteteve për t'iu përgjigjur kërkesave të reja.

Të gjitha këto bëhen gjatë dhe pas zbatimit të aktiviteteve. Planifikimi i vlerësimit mundëson shqyrtimin e suksesit dhe modifikimin me kohë të aktiviteteve gjatë implementimit.

Burimi: Marrë dhe përshtatur nga “Udhëzues për procesin e konsultimeve publike”, Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit (2011)

Figura 2: Hapat e Planit të Pjesëmarrjes publike për procesin e planifikimit hapësor




Tabela 2: Nivelet e pjesëmarrjes publike me teknikat përkatëse për Planin Zhvillimor Komunal

Niveli i pjesëmarrjes		Planin Zhvillimor Komunal - PZHK		
Dokumentet e PH	Faza e planifikimit	Faza para planifikimit/përgaditore	Faza e planifikimit	Faza pas planifikimit (zbatim, monitorim, vlerësim i zbatimit të PZHK, revidimi)
INFORMIMI	Qëllimi	Ti ofrohet publikut informacioni i nevojshëm për të ndihmuar ata në të kuptuarit e problemeve, alternativave dhe zgjidhjeve të ofruara përmes PZHK-së dhe për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrjen publike gjatë të gjitha fazave të planifikimit dhe zbatimit të tij.	Përmes teknikeve përkatëse, informimi përdoret gjatë të gjitha fazave të planifikimit që përfshijnë: profilin dhe vlerësimin e gjendjes, krijimin e zhvillimit hapësor (vizion, qëllimet dhe objektivat, koncepti i zhvillimit hapësor, politikat) si dhe fazën e përcaktimit të prioriteteve strategjike dhe planit të veprimit.	* Për të informuar publikun gjatë gjithë kohës për zbatimin e projekteve/aktiviteteve të PZHK-së. * Për të informuar publikun për gjendjen e zbatimit të PZHK-së përmes bërjes publike të raportit vjetor të monitorimit të zbatimit të planit
	Përdorimi	Njoftimet publike në media të shkruara dhe elektronike (shkryp ditor, RTV kombëtare dhe lokale, faqja e internetit e komunës, rrjetet sociale etj), publikimi i raportit me propozimet dhe ankesat nga shqyrtimi publik, publikimi i raportit për zbatimin dhe monitorimin e planit	Njoftimet publike në media të shkruara dhe elektronike, materialet informative dhe edukative (broshura, fletpalosje, versioni i shkurtër i PZHK, posterat, dërgimi i sms-ave, anketime me qytetarë i pranueshëm publike pas çdo faze, ekspozimi publik gjatë shqyrtimit publik, peticionet, raportet i shqyrtimit publik.	
	Teknikat	T'u ofrohet qytetarëve mundësia të japin komente, kontribuojnë apo reagojnë mbi analizën, alternativat, zgjidhjet e ofruara me PZHK-së dhe zbatimin e tij.	Në fazën e përgaditjes mund të themelimin e Grupit Këshilldhënës të komunitetit, mund të mbahen konsultime me përfaqësues të komunitetit lidhur me emërtimin e anëtarëve të GKK.	* Për të konsultuar publikun kur është e nevojshme për zbatimin e projekteve të dala nga PZHK; * Gjatë rishtimit të PZHK kur konsultimi për çështje të caktuara është i domosdoshëm; * Për të marrë informacione dhe reageime nga publiku për zbatimin e PZHK-së dhe kuptuar efektet nga zhvillimet e planit.
KONSULTIMI	Qëllimi	Në fazën e përgaditjes mund të themelimin e Grupit Këshilldhënës të komunitetit, mund të mbahen konsultime me përfaqësues të komunitetit lidhur me emërtimin e anëtarëve të GKK.	Në fazat e herësme të hartimit të planit përdoret për të identifikuar problemet, sfidat, grumbullimin e të dhënave të nevojshme, zhvillimin e vizionit, marrë reagimet e publikut mbi qëllimet dhe objektivat e planit, marrë ide mbi prioritetet strategjike, testuar propozimin për përgjigjen e skenarit me të mirë etj. Në fazat e vonshme kur ekziston draft-planit, konsultimi zhvillohet për të informuar publikun por edhe për të verifikuar zgjidhjet/propozimet e planit.	
	Përdorimi	Në fazën e përgaditjes mund të themelimin e Grupit Këshilldhënës të komunitetit, mund të mbahen konsultime me përfaqësues të komunitetit lidhur me emërtimin e anëtarëve të GKK.	Në fazat e herësme të hartimit të planit përdoret për të identifikuar problemet, sfidat, grumbullimin e të dhënave të nevojshme, zhvillimin e vizionit, marrë reagimet e publikut mbi qëllimet dhe objektivat e planit, marrë ide mbi prioritetet strategjike, testuar propozimin për përgjigjen e skenarit me të mirë etj. Në fazat e vonshme kur ekziston draft-planit, konsultimi zhvillohet për të informuar publikun por edhe për të verifikuar zgjidhjet/propozimet e planit.	
	Teknikat	Takim me grup të fokusit përfaqësues të komunitetit	Anketimi, intervistat dhe pyetësorët, takimet publike me banorë, grupet e fokusuar, diskutimet publike, shqyrtimi publik etj.	Anketimi, intervistat dhe pyetësorët, takimet publike me banorë, grupet e fokusuar, diskutimet publike, etj
DIALOGU	Qëllimi	Duke punuar direkt me publikun, të sigurohet ai që shqetësimet dhe aspiratat e tyre janë kuptuar dhe janë marrë në konsideratë gjatë hartimit/zbatimit të planit	Në fazat e planifikimit përdoret kur kërkohet pajtueshmëri me publikun për çështje të caktuara p.sh. në fazën e konceptit të zhvillimit hapësor me saktësi të përgjithshme së skenarit me të mirë të zhvillimit hapësor kur përcaktohet shryrëzimi i tokës. Dialogu mund të jetë i nevojshëm edhe në fazën e shqyrtimit publik.	* Kur gjatë zbatimit të projekteve të dala nga PZHK për ndonjë çështje të caktuar është i domosdoshëm negociimi, arritja e konsensusit apo zgjidhja e kontesteve eventuale; * Gjatë revidimit të planit me ç'rast dialogu me palët të caktuara të interesit është i domosdoshëm për ndryshimet e bëra;
	Përdorimi	Në fazën e planifikimit përdoret kur kërkohet pajtueshmëri me publikun për çështje të caktuara p.sh. në fazën e konceptit të zhvillimit hapësor me saktësi të përgjithshme së skenarit me të mirë të zhvillimit hapësor kur përcaktohet shryrëzimi i tokës. Dialogu mund të jetë i nevojshëm edhe në fazën e shqyrtimit publik.	Në fazat e planifikimit përdoret kur kërkohet pajtueshmëri me publikun për çështje të caktuara p.sh. në fazën e konceptit të zhvillimit hapësor me saktësi të përgjithshme së skenarit me të mirë të zhvillimit hapësor kur përcaktohet shryrëzimi i tokës. Dialogu mund të jetë i nevojshëm edhe në fazën e shqyrtimit publik.	* Forumet publike të komunitetit, komitetet këshilluese, seminarët, vizionimi, seancat e ndërmjetësimit etj
	Teknikat	Punëtori	Anketimi, intervistat dhe pyetësorët, takimet publike me banorë, grupet e fokusuar, diskutimet publike, shqyrtimi publik etj.	Forumet publike të komunitetit, komitetet këshilluese, seminarët, vizionimi, seancat e ndërmjetësimit etj
PARTNERITETI DHE FUQIZIMI	Qëllimi	Të arrihet partneriteti me përfaqësues të komunitetit në marrjen e vendimeve apo/dhe delegimin e përgjegjësi të caktuara tek ata respektivisht vendosja e vendimarrjes përfundimtare në duar të publikut.	* Në këtë fazë partneriteti mund të vendoset me ndonjë OIQ ose atyre me bazë komunitet si pjesë e ekipit të përfaqësues menaxhues, krijimi e trupave të përfaqësues të pjesëmarrjes si Grupi Këshilldhënës të Komunitetit dëni të krijimi i trupave të përfaqësues të vendimarrjes	* Gjatë zbatimit të planit kur ekziston nevojja për partneritet të rëndësishëm në zbatimin e vendimeve. * Gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, me theks në aprovimin e raportit vjetor të zbatimit të planit; * Gjatë revidimit të planit, në momentet kur mirren vendime për ndryshimet e nevojshme në plan.
	Përdorimi	Të arrihet partneriteti me përfaqësues të komunitetit në marrjen e vendimeve apo/dhe delegimin e përgjegjësi të caktuara tek ata respektivisht vendosja e vendimarrjes përfundimtare në duar të publikut.	* Në këtë fazë partneriteti mund të vendoset me ndonjë OIQ ose atyre me bazë komunitet si pjesë e ekipit të përfaqësues menaxhues, krijimi e trupave të përfaqësues të pjesëmarrjes si Grupi Këshilldhënës të Komunitetit dëni të krijimi i trupave të përfaqësues të vendimarrjes	* Gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, me theks në aprovimin e raportit vjetor të zbatimit të planit; * Gjatë revidimit të planit, në momentet kur mirren vendime për ndryshimet e nevojshme në plan.
	Teknikat	Koalicione dhe partneritetet, Grupet Këshilldhënës të Komunitetit, Juritë e Qytetarëve	Koalicione dhe partneritetet, Grupet Këshilldhënës të Komunitetit, Juritë e Qytetarëve	Koalicione dhe partneritetet, Grupet Këshilldhënës të Komunitetit, Juritë e Qytetarëve

Tabela 3: Nivelet e pjesëmarrjes publike me teknikat për Hartën Zonale të Komunës

Niveli i pjesëmarrjes	Harta Zonale e Komunës - HZK	
	Faza para planifikimit/përgaditore	Faza e planifikimit
INFORMIMI	Dokumenti I PH	Faza para planifikimit/përgaditore
	Fazat e planifikimit	Faza e planifikimit
	Qëllimi	T'i ofrohet publikut informacion objektiv, për të ndikuar në aftësinë dhe ndihmën ata në të kuptuarit e përmbajtjes së HZK si dhe për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrjen publike gjatë të gjitha fazave të planifikimit dhe zbatimit të HZK
KONSULTIMI	Përdorimi	Për të informuar publikun për iniciimin e hartimit të HZK, aranzhimet dhe punët përgaditore
	Teknikat	Njoftimet publike në media të shkruara dhe elektronike (shtypi ditor, RTV kombëtare dhe lokale, faqja e internetit e komunës, rrjetet sociale etj.) Varejësit nga: Illoji i aktivitetit, mund të përdoren këto teknika: Njoftimet publike në media të shkruara dhe elektronike, material informativ dhe edukativ (broshura, fletpalosje, posterat, dërgimi i sms-ave, prezantimet publike në komponentet e caktuara të HZK, ekspozimi publik i HZK gjatë shqyrtimit publik, peticionet, raportit i shqyrtimit publik.
	Qëllimi	T'u ofrohet qytetarëve mundësia të japin komente, kontribuojnë apo reagojnë mbi zonimin, kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore të përcaktuara me HZK si dhe me zbatimin e saj.
DIALOGU	Përdorimi	Takim me grup të fokus grup të përfaqësuesve të komunitetit
	Teknikat	Duke punuar direkt me publikun, të sigurohet ai që shprehësinet dhe aspiratat e tyre janë kuptuar dhe janë marrë në konsideratë gjatë hartimit/zbatimit të Komunës
	Qëllimi	Në fazën e themelimit të Grupit të Këshilldhënës të Komunitetit si dhe në përzgjedhjen e OIQ lokale përgjegjëse për të facilituar komunikimin me komunitetin (nëse për këtë qëllim bashkëpunimi me ndonjë OIQ shihet i nevojshëm).
PARTNERITETI DHE FUQIZIMI	Përdorimi	Punëtori
	Teknikat	Forumet publike të komunitetit, komitetet këshilluese, seminarat, vizionimi, seancat e ndërmjetësimit etj.
	Qëllimi	Të arrihet partneritet me përfaqësues të komunitetit në marrjen e vendimeve apo/dhe delegimin e përgjegjësi të caktuara tek ata respektivisht vendosja e vendimmarjes përfundimtare e ndërtimit të publikut.
PARTNERITETI DHE FUQIZIMI	Përdorimi	Në këtë fazë partneriteti mund të vendoset me ndonjë organizatë të shoqërisë civile ose atyre me bazë komuniteti si pjesë e ekipit të përbashkët menaxhues, krijimin e trupave të përbashkëta të pjesëmarrjes si Grupi Këshilldhënës të Komunitetit deri të krijimi trupave të përbashkëta të vendimmarjes
	Teknikat	Koalicionet dhe partneritetet, Grupet Këshilldhënës të Komunitetit, Juritë e Qytetarëve
	Qëllimi	Në fazën e hartimit të HZK, dialogu përdoret kur kërkohet pajtueshmëri me palët të interesit për çështje të caktuara, në veçanti është i domosdoshëm në deshimin e zonave dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore për to, duke përfshirë kushtet ndërtimore.
PARTNERITETI DHE FUQIZIMI	Përdorimi	Forumet publike të komunitetit, komitetet këshilluese, seminarat, vizionimi, seancat e ndërmjetësimit etj.
	Teknikat	Anketimi, intervistat dhe pyetësorët, takimet publike me banorë, grupet e fokusuar, diskutimet publike, shqyrtimi publik etj.
	Qëllimi	Në fazën e hartimit të HZK, dialogu përdoret kur kërkohet pajtueshmëri me palët të interesit për çështje të caktuara, në veçanti është i domosdoshëm në deshimin e zonave dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore për to, duke përfshirë kushtet ndërtimore.
PARTNERITETI DHE FUQIZIMI	Përdorimi	Forumet publike të komunitetit, komitetet këshilluese, seminarat, vizionimi, seancat e ndërmjetësimit etj.
	Teknikat	Anketimi, intervistat dhe pyetësorët, takimet publike me banorë, grupet e fokusuar, diskutimet publike, etj
	Qëllimi	Në fazën e hartimit të HZK, dialogu përdoret kur kërkohet pajtueshmëri me palët të interesit për çështje të caktuara, në veçanti është i domosdoshëm në deshimin e zonave dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore për to, duke përfshirë kushtet ndërtimore.

Tabela 4: Nivelet e pjesëmarrjes publike me teknikat përkatëse për Planin Rregullues të Hollësisë

Niveli i pjesëmarrjes	Plani Rregullues i Hollësisë - PRRH	
	Faza para planifikimit/përgaditore	Faza e planifikimit
INFORMIMI	Dokumenti I PH	Faza para planifikimit/përgaditore
	Fazat e planifikimit	Faza e planifikimit
	Qëllimi	T'i ofrohet publikut informacion objektiv, për të ndikuar në aftësinë dhe ndihmën ata në të kuptuarit e përmbajtjes së PRRH si dhe për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrjen publike gjatë të gjitha fazave të planifikimit dhe zbatimit të PRRH në veçanti të interesit dhe aspiratave të banorëve të zonës që trajtohet me plan.
INFORMIMI	Përdorimi	Për të informuar publikun për iniciimin e hartimit të PRRH, aranzhimet dhe punët përgaditore
	Teknikat	Njoftimet publike në media të shkruara dhe elektronike (shtypi ditor, RTV kombëtare dhe lokale, faqja e internetit e komunës, rrjetet sociale etj.) Në këtë rast njoftimi në veçanti duhet të ketë në target palët e interesit dhe banorët e zonës për të cilën hartohet PRRH.
	Qëllimi	T'u ofrohet qytetarëve, në veçanti palëve të interesit dhe banorëve të zonës për të cilën hartohet plani, mundësia të japin komente, kontribuojnë apo reagojnë mbi kushtet ndërtimore dhe ato për rregullimin e zonës të përcaktuara me PRRH si dhe me zbatimin e planit.
KONSULTIMI	Përdorimi	Takim me përfaqësues të bashkësive lokale apo grup të fokus grup të përfaqësuesve të komunitetit
	Teknikat	Duke punuar direkt me publikun në veçanti me grupet e fokusuar/gjatë hartimit/zbatimit të PRRH.
	Qëllimi	Në fazën e themelimit të Grupit të Këshilldhënës të Komunitetit si dhe në përzgjedhjen e OIQ lokale përgjegjëse për të facilituar komunikimin me komunitetin (nëse për këtë qëllim bashkëpunimi me ndonjë OIQ shihet i nevojshëm).
DIALOGU	Përdorimi	Punëtori
	Teknikat	Forumet publike të komunitetit, komitetet këshilluese, seminarat, vizionimi, seancat e ndërmjetësimit etj.
	Qëllimi	Të arrihet partneritet me përfaqësues të komunitetit në marrjen e vendimeve apo/dhe delegimin e përgjegjësi të caktuara tek ata respektivisht vendosja e vendimmarjes përfundimtare në duar të publikut.
PARTNERITETI DHE FUQIZIMI	Përdorimi	Në këtë fazë partneriteti mund të vendoset me ndonjë OIQ ose organizatë të shoqërisë civile ose atyre me bazë komuniteti si pjesë e ekipit të përbashkët menaxhues, krijimin e trupave të përbashkëta të pjesëmarrjes si Grupi Këshilldhënës të Komunitetit deri të krijimi trupave të përbashkëta të vendimmarjes.
	Teknikat	Koalicionet dhe partneritetet, Grupet Këshilldhënës të Komunitetit, Juritë e Qytetarëve
	Qëllimi	Në fazën e hartimit të HZK, dialogu përdoret kur kërkohet pajtueshmëri me banorë dhe palët të interesit për çështje të caktuara. P.sh dialogu është i domosdoshëm gjatë fazës së riparimit, përcaktimit të kushteve ndërtimore dhe atyre për rregullimin e hapësirës për zonat urbane dhe rurale.

Kapitulli IV:

Komunikimi dhe kthimi i përgjigjeve tek publiku

Planifikimi hapësinor ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve, në mënyrën se si ata udhëtojnë për në punë, ku shkojnë fëmijët e tyre në shkollë, mundësitë ekonomike për komunitet, qasshmëria në infrastrukturë bazike dhe në përgjithësi në kualitetin e jetës që ata e përjetojnë çdo ditë.

Për shkak të kësaj është e rëndësishme për zyrtarët komunal të komunikojnë me publikun dhe të përfshijnë ata në vendime përgjatë gjithë procesit të planifikimit hapësinor. Përfshirja e publikut ndonjëherë nuk është e lehtë, takimet publike mund të sjellin në situatë të diskutueshme/grindavece, pasi që njerëzit jo gjithmonë pajtohen, dhe shumë prej tyre nuk ndihen mirë të flasnin para grupit.

Planifikimi paraprak dhe praktikimi i veglave bazike të komunikimit mund të ndihmojë që të lehtësohen të gjitha shqetësimet të përmendura sipër. Ky kapitull fokusohet në komunikim, si aftësi personale dhe mënyrë e të sjellurit, si dhe në kthimin e përgjigjes, të dyja këto të nevojshme për të drejtuar një proces të suksesshëm të planifikimit me pjesëmarrje.

4.1 Komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë lokale

Komunikimi është lëmi shumë e gjerë e cila mbulon mënyra dhe vegla të të ndryshme ku autoritetet komunale mund të komunikojnë për të ngritur pjesëmarrjen dhe vetëdijen e qytetarëve. Komunikimi i mirë nga qeveria lokale tek qytetarët merr kohë dhe resurse, por kjo shpaguhet me besim dhe mirëkuptim të ndërsjellë. Kjo do të thotë që zyrtarët komunal duhet ta marrin seriozisht mënyrën se si qeveria lokale komunikon me publikun në lidhje me proceset e planifikimit.

Gjithashtu, komunikimi kërkon që qytetarët të shfrytëzojnë mundësinë e cila u është ofruar, duke kuptuar më shumë rreth çështjeve të cilat janë duke ndodhur në qytetin apo qytezën e tyre, si dhe të ndajnë këndvështrimet e tyre me qeverinë lokale. Për të u siguruar që kjo ndodhë nuk është gjithmonë punë e lehtë, përderisa në demokracitë e reja është e nevojshme që qeveritë të ndërmarrin masa të veçanta. Edukimi dhe kampanja për ngritje të vetëdijes, mund të konsiderohen si të domosdoshme në mënyrë që të ndihmojë qytetarët të kuptojnë rëndësinë e përgjegjësive të tyre në mënyrë që të ndërveprojnë në mënyra konstruktive me qeverinë e tyre.

Skema e mëposhtme ilustron mënyra dhe vegla të ndryshme përmes së cilave qytetarët dhe qeveritë lokale mund të komunikojnë me njëra tjetrën.




Fig 2. Mënyra dhe vegla të ndryshme përmes së cilave qytetarët dhe qeveria mund të komunikojnë njëri me tjetrin.

4.2 Rregullat bazë për trajtimin e procesit efektiv të komunikimit

a) Zgjidh kanalet e informacionit dhe komunikimit

Gjatë zbatimit të një plani të pjesëmarrjes publike, shtrohet pyetja se cilat kanale të komunikimit janë më të përshtatshme për t'u përdorur, p.sh. të cilat kanale janë më të përdorura dhe më të besueshme për grupet e synuara. Edhe pse televizioni është konsideruar si media që ka ndikimin më të madh në publik, do të jetë më mirë të përdoren të gjitha llojet e mediave janë të mundshme (radio, shtypi, interneti), si dhe kanale të tjera të komunikimit (billborde në vende publike, takime individuale, SMS grupe, mesazheve elektronike, shpërndarja e fletëpalosjeve, etj).

Njohja e palëve të interesit nga ana e autoriteteve komunale i ndihmon ata në përzgjedhjen e qasjes adekuate për përfshirjen e tyre në procesin e pjesëmarrjes publike duke siguruar ndikim maksimal - p.sh. duke e ditur se çfarë gjuhe duhet përdorur dhe niveli i informacionit që duhet të sigurohet për të palëve të interesuara në çështjet në diskutim.

Përzgjedhja e kanaleve të komunikimit mund të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- Njoftime për media ku një komponentë më e madhe e publikut mund të arrihet për shembull në shpalljen e një vendimi apo politike specifike;
- Përdorimi i raporteve të publikuara për shpërndarje tek palët e interesuara ose postimi në faqet e internetit të komunave;
- Billbordet, shënimet dhe posterat në ekranet ekspozuese mediatike mund të jenë efektive; për komunikimin me kosto të ulët mund të përdoren posterët e shtypur në format A3 dhe atë në një sasi të kufizuar, ato mund të vendosen në ndërtesat publike apo në lokacionet tjera të frekuentuara të një zone të caktuar gjeografike (shkolla, objekte shëndetësore dhe sportive, supermarkete, qendra tregtare etj).
- Për të pasur arritshmëri të gjerë, Facebook dhe mediat tjera sociale mund të përdoren si një mënyrë me kosto të ulët e shkëmbimit të informacionit dhe komunikimit; t'i kushtohet vëmendje targeteve dhe zgjedhjes me kujdes të fjalëve kyçe.
- Për çështje specifike në një fushë të caktuar, komunikimi personal është shumë i dobishëm. Kjo mund të bëhet përmes komunikimit sy më sy në mes zyrtarëve të administratës lokale dhe komunitetit. Komunikimi personal gjithashtu mund të bëhet përmes mesazheve telefonike, shkrimit të letrave, telefonatave, emailave, faqeve të internetit të rrjeteve sociale, etj.

b) Siguroni mundësinë për paraqitjen e komenteve

Çdo anëtar i interesuar i publikut ka të drejtë të paraqesë komente apo sugjerimet gjatë procesit të pjesëmarrjes së publikut. Ofrimi i informacionit të duhur paraprakisht

do të sigurojë se komuniteti mund të merr pjesë në mënyrë domethënëse në takime dhe të paraqesë komentet /sugjerimet e tij.

Në raste të kërkesave ligjore, siq është shqyrtimi publik për dokumentet e planifikimit hapësinor, duhet të ndiqet një procedurë e caktuar e ankimit duhet të ndiqet. Në rastet tjera, mënyrat dhe format për dorëzimin e komenteve dhe mendimeve tek autoritetet kompetente varen nga teknikat e përdorura të pjesëmarrjes publike.

Autoritetet kanë për obligim për t'iu përgjigjur qytetarëve. Mënyra e preferuar është që të përdorin të njëjtën formë që është përdorur për të siguruar sugjerim apo mendim (p.sh. kthimi i përgjigjes me shkrim në qoftë se komentet janë dorëzuar me shkrim). Nëse është akumuluar një numri madh të komenteve, është e preferueshme për të përgatitur një raport i cili do të përmbledhë dhe strukturojë komentet sipas përmbajtjes së tyre, dhe i njëjti të publikohet nëpërmjet kanaleve të komunikimit të përdorura gjatë procesit të pjesëmarrjes.

c) Komunikoni vendimet në lidhje me procesin e pjesëmarrjes dhe ofroni përgjigje

Të gjitha kontributet duhet të regjistrohen dhe të merren parasysh gjatë vendimmarrjes në proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Kjo do të thotë se autoritetet duhet të analizojë komentet, trajtojnë ato që kontribuojnë për zgjidhje të caktuara që lidhen me dokumentin e planifikimit hapësinor, dhe përgadisin arsyetim për kontributet / komentet të cilat nuk janë marrë parasysh.

Ofrimi i përgjigjeve tek publiku, rreth integritit të komenteve dhe sugjerimeve të tyre në vendimmarrje siguron transparencë të procesit të pjesëmarrjes publike dhe siguron kredibilitetin e procesit. Kjo do të demonstrojë publikut se koha dhe përpjekja e tyre nuk ka qenë e kotë dhe se nevojat, brengat, mendimet dhe komentet e tyre janë kuptuar dhe marrë parasysh. Kjo do të sigurojë më shumë përkushtim në të ardhmen nga palët e interesit në mënyrë që të jenë të përfshirë në proceset e pjesëmarrjes publike të komunës. Publiku do të ndjehet se mendimet e tyre janë marrë parasysh.

Kthimi i informacionit/përgjigja duhet t'ju dërgohet të gjithë pjesëmarrësve dhe duhet të jetë i qasshëm dhe në dispozicion për publikun. Përgjigja duhet të kthehet me kohë, pa vonesa dhe duke përdorur kanalet e duhura të komunikimit.

Gjatë vlerësimit të rezultateve të pjesëmarrjes publike në proceset e planifikimit hapësinor, qeveria lokale duhet të marrë në konsideratë:

- A janë informuar me kohë palët e interesit për atë se si kontributi i tyre ka ndikuar në vendimet?
- A kanë qenë të duhura veglat/mjetet e përdorura të komunikimit?

- A kanë pasur palët e interesit për të dhënë komente mbi;
- kënaqshmërinë e tyre me procesin e pjesëmarrjes së publikut?
- sfidat të cilat i kanë identifikuar në proces?
- A është përdorur gjuha e duhur gjatë kthimit të përgjigjeve?

Gjithashtu, paketa duhet të përmbajë informacion në lidhje me mundësitë për ankesë kundër vendimit.

4.3. Aftësitë e komunikimit dhe lehtësimit (fasilitimit)

Në mënyrë që të kemi një proces efektiv të pjesëmarrjes së publikut, autoritetet lokale duhet të zhvillojnë aftësi të veçanta të komunikimit në mënyrë që të menaxhojnë më lehtë situatat konfrontuese gjatë takimeve publike dhe ngjarjeve tjera kur aplikohet komunikimi sy më sy. Kryesisht janë dy aftësi të cilat nevojiten për komunikimi të palëve të sipër përmendura:

- Dëgjimi aktiv
- Bërja e pyetjes së duhur

Dëgjimi aktiv shkon përtej dëgjimit të zakonshëm. Dëgjim aktiv do të thotë të qenit i koncentruar kur tjetri flet. Qëllimi i të dëgjuarit aktiv është që të kuptohen ndjenjat dhe këndvështrimet e një personi. Përfaqësuesit e autoriteteve lokale duhet vënë theks të veçantë në mënyrën se si u përgjigjen qytetarëve të duan që mendimet e tyre të dëgjojnë dhe të kuptohen. Një shprehje e thjeshtë “faleminderit për atë koment” mund të jetë e dobishme. Jo për secilin nga komentet duhet të ofrohet përgjigje, por çdo koment duhet të pranohet. Mirënjohje të dobishme janë:

- “Faleminderit për atë koment.”
- “Shumë faleminderit për këtë.”
- “Jam e kënaqur që e vurët në pah këtë.”
- “Në rregull – faleminderit.”
- “Çështje me vend. Faleminderit që e ndatë këtë.”
- “Shumë mirë.”

Ata duhet të dëgjojnë pa paragjykime, duhet të identifikojnë dhe pranojnë ndjenjat e tjetrit qytetarit/pjesëmarrësit, dhe në mënyrë që të kuptojnë plotësisht situatën.

Bërja e pyetjes së duhur është gjithmonë e ndërlidhur me dëgjimin aktiv, por shfrytëzohet për të thelluar informatën e cila veçse është përçarë tek publiku mënyrë që të shmanget keqkuptimi ose të ri fokusohet nëse ka filluar të merr kahje tjetër.

Të dy shkathtësitë e mësipërme janë aftësi ndërpersonale që janë të dobishme gjatë angazhimit në aktivitetet e planifikimit me pjesëmarrje .

Këshilla për komunikim efektiv me publikun

- Të gjithë të marrin pjesë, askush të mos dominojë
- Suksesi varet nga pjesëmarrja – shpërndani idetë, bëni pyetje
- Dëgjoni për të kuptuar
- Kërkoni unitet (jo ndarje)
- Nëse nuk pajtoheni bëjeni atë pa u vrenjtur
- Flisni me ndershmëri
- Qëndro i hapur për mënyra të reja të të bërit të gjërave
- Jini pozitiv, jo-gjykues dhe të hapur për ide të reja
- Mbani mend përgjegjësinë dhe jo-vetëmbrojtjen
- Qëndroni në nivel strategjik (larg nga niveli operativ)
- Çdo gjë që ndodh përmes bisedës
- Respekti mendimin e njëri-tjetrit dhe vlerësojnë kontributin e tyre
- Artikuloni supozimet e fshehura
- Menaxhoni punën në grup
- Qëndrimi në orar është përgjegjësi e të gjithëve; respekti afatet kohore
- Lejo çdo zë që të dëgjohet; Nxituni nga dallimet që dëgjoni
- Pyesni “çfarë është e mundur?” Jo “çfarë është e gabuar?”
- Kërkoni bazën e përbashkët dhe mirëkuptim (jo probleme dhe konflikt)
- Mos kini frikë nga komentet negative. Njerëzit mund të mos pajtohen, por të dëgjuarit se çfarë thonë ata e ka vlerën e vet.

Aktivitetet e pjesëmarrjes publike si p.sh. shqyrtimet publike, takimet e fokus grupeve aktivitete tjera të përmendura në këtë udhëzues – kërkojnë shkathtësi të mira në punën lehtësuese.

Këto shkathtësi janë të rëndësishme gjatë zhvillimit të aktiviteteve që adresojnë çështje të diskutueshme dhe ku mundësia e ballafaqimit konfliktuoz mes palëve është relativisht e lartë. Në mënyrë që të mbahen takime apo debate efektive publike, është e rëndësishme që:

- 1) të jeni mire të përgatitur për mbledhjen;
- 2) të siguroni njoftim efektiv publik, dhe
- 3) të drejtoni takimin në një mënyrë të respektueshme, ku anëtarët e publikut janë dëgjuar dhe pasur mundësi adekuate për të dhënë komentet e tyre

Më poshtë jepen disa këshilla të vlefshme për lehtësuesit:

- Fillo në kohë;
- Prezanto veten dhe kërko nga të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë.
- Prezanto rregullat bazë dhe procesin në fillim të takimit. P.sh: shpjego se kur do jetë koha për pyetje, bëju të qartë pjesëmarrësve nevojën për të respektuar njëri-tjetrin, kërkoju pjesëmarrësve të fikin celularët ose të çaktivizojnë zilet, etj.
- Shpjego qëllimin e takimit. Prezanto formatin e takimit/programin. Sigurohu që të gjithë i kuptojnë detyrat.
- Sigurohuni të keni udhëzime të qarta se si të marrësh pjesë dhe çfarë të presësh meqë për shumë njerëz ky mund të jetë ndërveprimi i parë me institucionet vendore.
- Sigurohuni që keni kopje të mjaftueshme të rendit të ditës, materialet eshtypura dhe pako informuese.
- Shpërndaji materialet e shkruara tek të gjithë pjesëmarrësit .
- Mos lejoni asnjë lloj frikësim në takime.
- Krijoni një atmosferë mikpritëse e cila inkurajon komentet nga publiku dhe jo atmosferë kërcënuese.
- Sigurohu që të flasësh në gjuhë adekuate (jo teknike) dhe të përshtatshme për audiencën.
 - Prezanto gjendjen e tanishme hapësinore.
 - Shpjegoni problemet e identifikuar deri tani dhe pengesat e zhvillimit.
 - Përdorni hartat dhe grafikët që prezantimi të jetë sa më ilustrues.
 - Përdorni mënyrat e ndryshme të prezantimit / ndërveprimit: të bazuara në elektronikë (poëer point , Prezi , etj) apo edhe në letër (flipchart), etj.
- Ofroni materialet, duke përfshirë edhe kontekstin për çështje / temat që do të diskutohen.
- Prezanto folësin dhe kontrollo kohën. Të pasurit e limiteve kohore për komentet e publikut është për të ardhur keq, por kjo është e domosdoshme në mënyrë që të menaxhohen siç duhet takimet që ndonjëherë mund të zgjasin deri në orë të vona. Është gjithashtu e rëndësishme të jipet një rikujtim për komentuesit që të mos përsërisin atë që dikush tjetër e ka thënë. Lejoni ata që të shprehin pajtueshmërinë, por jo të përsëritin atë çfarë është thënë. Gjithashtu, për grupe të caktuara siq janë komunitetet lokale, shpesh është efektive nëse një zëdhënës që e përfaqëson tërë grupin mund të japë mendimet për të gjithë ata. Në këto raste atij duhet dhënë më shumë kohë.
- Stimulo diskutime për të siguruar ecurinë. Në mënyrë që të inicohet dhe për të pasur diskutim të vlefshëm si lehtësues duhet të jeni të familjarizuar me çështjet si:

- Çka është me të vërtetë e rëndësishme për komunitetin?
- Cilat janë problemet më të mëdha të komunitetit?
- Çfarë dëshiron komuniteti? Cilat janë shprehitë e tyre?

Në momentin që pyetjet e lartpërmendura janë të qarta për lehtësuesin, zhvillimi dhe stimulimi i diskutimit mbi çështje specifike është shumë më i lehtë. Tema më tutje mund të elaborohet duke ndjekur pyetjet siq vijojnë:

- Cila është mënyra më e mirë e adresimit të kësaj çështje?
- Sa prej jush keni gjetur që çështja {x} është me të vërtetë e vështirë?
- A keni gjetur se...?

Ajo që duhet të mbahet në mend se si lehtësues ju nuk duhet gjithmonë të kërkonti zgjidhje , ty të duhet që njerëzit tjerë të identifikojnë se edhe ata kanë të njëjtin problem. Pyesni disa nga anëtarët se cilat janë problemet e tyre më të mëdha, pyesni se për çfarë ata me të vërtetë kujdesen, dhe kërkonte se çfarë duan ata në lidhje me temën? Pyetjet e lartpërmendura tentojnë të kërkojnë komente në temën e synuar.

- Dëgjoni atë që njerëzit kanë për të thënë, mos u fjalosni: Me durim dëgjoni derisa çdo person i cili dëshiron të flasë ka thënë fjalën e vet. Kjo është pjesa ku afati kohor hyn në funksion për t'ju ndihmuar. Por më e rëndësishmja, në qoftë se gjithkush e kupton se zëri i tij do të dëgjohej, atëherë ata do të kenë durimin të qëndrojnë ulur dhe të mos prishin mbledhjen.
- Sigurohu që të gjithë të kenë mundësi të flasin. Mos lejoni që publiku të ndërhyjë kur dikush tjetër e ka fjalën. Në qoftë se përsëritja tek anëtarët e publikut për të pritur radhën e tyre nuk funksionon, ndaloni takimin dhe le të gjithë të ulen dhe qetësohen derisa vihet përsëri nën kontroll.
- Mbani mendjen e hapur: Qëndroni të qetë dhe mbani një mendje të hapur. Mos harroni se ju përfaqësoni institucionin dhe jo mendimet tuaja personale. Kjo është shumë e rëndësishme.
- Përmabajuni agjendës dhe qëndroni në temë: Lehtësuesi i efektshëm është ai që e mban takimin në rrugën e duhur.
- Përballo me çdo lloj konflikti, menaxho sjelljet problematike dhe/ose kontributet që nuk përkojnë me objektin e takimit.
- Përfundoje takimin duke bërë një përmbledhje të konkluzioneve dhe hapave pasardhës

Fasilituesi duhet gjithashtu të:

- Të jeni i familiarizuar me të gjitha çështjet në diskutim; por nuk duhet të jeni një ekspert në asnjë. Në fakt, njohja e shumë hollësive teknikalitetet mund të ndërhyjë në procesin e nxitjes së publikut për të shprehur veten, i cili është roli që pritet të luajnë.
- Gjithmonë të jeni i drejtë. Kjo është ndoshta përgjegjësia më e rëndësishme e lehtësuesit. Drejtësia do të thotë gjithashtu që tu jepni të gjithëve një shans për të folur dhe të merreni shpejt dhe me vendosmëri me ata që përpiqen të dominojnë diskutimin. Si një lehtësues, qëllimi juaj është të jeni i drejtë për të gjithë, pavarësisht nëse pajtoheni apo nuk pajtohen me ta.
- Ruani ekuilibrin e duhur në mes të formalitetit dhe joformalitetit. Shumë njerëz ende pëlqejnë të thirren me mbiemra, por emrat janë të pranueshëm në qoftë se i njihni ata mirë, ose kjo është në stilin e komunitetit tuaj.

Në vend të përfundimit...

Ky udhëzues nxit zyrtarët të shohin përpara – të jenë mirë të organizuar dhe të bëjnë plane, por gjithashtu edhe të jenë fleksibil, të vendosur dhe kreativ në planifikimin e pjesëmarrjes publike, me qëllim që të mund të marrin vendime më të mira. Udhëzuesi nxit komunitetin të jetë bashkëpunues dhe pjesëmarrës aktiv duke kontribuar në proceset e planifikimit që zhvillohen në dobi të tyre dhe komunës në përgjithësi.

Për të siguruar zhvillimin e një procesi të mirëfilltë të pjesëmarrjes publike, është e nevojshme që të ndërtohet një kulturë e komunikimit të vazhdueshëm mes vendim-marrësve dhe publikut. Ky është çelës për krijimin e një marrëdhënie besimi të ndërsjellë i cili është bazë për legjitimitetin evendimeve të planifikimit hapësinor.

ANEKSI 1:

QASJA NË MBLEDHJEN E TË DHËNAVE NË AKTIVITITETET E PJESËMARRJES PUBLIKE

Qasja në mbledhjen dhe analizën e të dhënave për punët kërkimore që përfshijnë pjesëmarrjen e publikut në proceset e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor përfshin hapat logjikë:

1. Identifikimi i target publikut dhe mostra – Varësisht nga dokumenti që hartohet dhe në varësi të dhënave që do të mblidhen, target publikut përfshinë të gjithë banorët e komunës (p.sh në rastin e hartimit të PZHK dhe HZK kur shihet e nevojshme mbledhja e ndonjë të dhëne me relevancë hapësinore e cila nuk mund të sigurohet përmes burimeve tjera) apo gjithë banorët e lagjes (p.sh. kjo vlen në rastin e hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme për zona apo lagje të caktuara);

Në rastet kur për çështje të planifikimit qëllimi është të marrim të dhëna jo nga e gjithë popullata, mund të përdoret metoda e mostrës e cila mund të bëhet në dy mënyra: të rastësishme e cila përfshinë përzgjedhjen me short të një numri të caktuar të banorëve në kuadër të komunës apo numër të caktuar të banorëve nga të gjitha lagjet, një numër të caktuar nga secili grup i interesit si dhe përzgjedhja jo e rastësishme e cila përfshin përzgjedhjen e qëllimshme të një numri të konsiderueshëm nga secili grup i interesit apo vullnetarëve dhe kujtdo që dëshiron të ofrojë informacion;

2. Mbledhja e të dhënave – Në proceset e planifikimit hapësinor, mbledhja e të dhënave bëhet gjatë fazës së planifikimit kur shihet i domosdoshëm sigurimi i të dhënave nga publiku për ndonjë çështje të caktuar (p.sh. në identifikimin e problemeve dhe sfidave, përcaktimin e prioritetëve, gjatë përcaktimit të kushteve zhvillimore e në veçanti të kushteve ndërtimore apo për ndonjë çështje specifike të planifikimit, etj). Mbledhja e të dhënave nga publiku bëhet gjithashtu edhe në fazën e vlerësimit të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor me qëllimin e të kuptuarit se a janë arritur qëllimet dhe objektivat e planit, si dhe çfarë efekte janë arritur me zbatimin e tyre. Mbledhja e të dhënave nga publiku bëhet përmes metodave të ndryshme si: pyetësorëve, intervistave, etj (shih më gjerësisht në aneksin 2 dhe 3).

3. Analiza dhe interpretimi i të dhënave – Është hap kalimtar mes atij të mbledhjes së një mori të dhënash dhe hapit të nxjerrjes së konkluzioneve. Në këtë hap rëndësi i kushtohet klasifikimit të dhënave sipas temës e në veçanti sipas aspektit gjinor, moshës dhe personave me nevoja të veçanta. Vëmendje e veçantë po ashtu duhet t'i kushtohet edhe prezantimin të dhënave të mara nga publiku. Analiza e të dhënave varet nga ajo se a janë të dhënat kuantitative apo kualitative. Analiza e të dhënave kuantitative kërkon interpretimin e rezultateve dhe verifikimin e kuptimisë së tyre. Disa pyetje që duhet bërë gjatë analizës janë: A kanë kuptim këto të dhëna? Si mundën numrat dhe rezultatet të na ndihmojnë të vendosim se çfarë veprimesh do të ndërmarim më tutje? etj.

Analiza e të dhënave kualitative duhet bërë në mënyrë sistematike. Në të shumtën e rasteve këto të dhëna sigurojnë rezultate reale. Për interpretimin e këtyre të dhënave kërkohen aftësi analitike.

4. Zhvillimi i konkluzioneve – Në këtë hap duhet pasur kujdes në nxjerrjen e përfundimeve të cilat janë të vlefshme dhe të besueshme por edhe të shprehura në mënyrën që të jenë të kuptueshme nga publiku.

ANEKSI 2:

PYETËSORËT

Çka janë pyetësorët:

Pyetësorët janë një nga mjetet themelore për mbledhjen e informatave për të kuptuar më mirë këndvështrimin e publikut lidhur me një çështje pa pasur nevojë të kontaktohen të gjithë. Mirëpo për të pas rezultate sa më të besueshme duhet të synohet një numër më i madh i qytetarëve. Pyetësorët përgatiten në atë mënyrë që pyetjet të jenë të qarta dhe lehtë të kuptueshme për të siguruar mbledhjen e informatave të nevojshme.

Pyetësorët mundësojnë mbledhjen e informatave në mënyrë të strukturuar dhe janë masë për vlerësimin e mendimit apo çështjeve të komunitetit në një kohë dhe zonë të caktuar. Pyetësorët mund të realizohen përmes intervistave sy-më-sy, intervistave përmes telefonit, formave që plotësohen nga vet të intervistuarit e të cilat mund të dërgohen me postë ose të jenë “online”. Duhet pas kujdes në sigurimin e resurseve të nevojshme për mbledhjen dhe analizimin e fletë-përgjigjeve.

Metodat e ndryshme krijojnë efekte në mënyrën e cila ndryshon varësisht nga përgjigja e të anketuarve, dhe metodat e ndryshme kanë përparësi të ndryshme. Mënyra më e zakonshme për kryerjen e pyetësorëve janë përmes:

- Telefonatave
- Postës dhe e-mail
- Online
- Anketimet e zhvilluara personalisht në shtëpi

Përparësitë:	Mangësitë:
<ul style="list-style-type: none">• Anonimiteti i të anketuarve inkurajon përgjigje më të sinqerta.• Një numër i madh i informatave mund të mbledhet brenda një kohe të shkurtër nga një numër i madh i pjesëmarrësve.• Përgjigje të standartizuara që e bëjnë atë të thjeshtë për mbledhjen e të dhënave• Mundëson qasjen te popullata e shpërndarë ose që jeton në një distancë të konsiderueshme.• Mundëson qasjen te të gjitha shtresat e popullatës.• I mundëson të anketuarve kohë të mjaftueshme për tu përgjigjur.• Mënyrë më ekonomike sepse mundëson intervistim të një numri më të madh për kosto më të ulët.	<ul style="list-style-type: none">• Kryesisht është i përdorshëm vetëm për të dhëna kualitative.• Përgjigja e ulët nga qytetarët rrezikon anshmëri të rezultateve.• Mund të ketë nevojë për kontaktim shtesë përmes telefonit apo postës për të nxjerrur kthimin e përgjigjeve.• Nuk ofron mundësi për sqarimin e pyetjeve, në rast se nuk është kuptuar ose interpretime të ndryshme të pyetjeve.• Varet nga niveli i shkollimit të anketuarve.

Mbledhja e të dhënave përmes pyetësorëve është e bazuar në pyetjet sasiore/statistikore dhe pyetjet cilësore. Gjithashtu përfshirja e citateve të pjesëmarrësve e ndihmon procesin dhe besueshmërinë e të gjeturave. Analiza dhe të gjeturat nga të dhënat e mbledhura mund të bëhen nga një ekip hulumtuesisht dhe të jenë të bazuara në metodologjinë e hulumtimit kualitativ dhe përmes kompjuterit të bazuara në hulumtim kuantitativ bazuar në përdorimin e paketës softwerike.

Rasti shembull i Prishtinës

PYETËSOR MBI IDENTIFIKIMIN E PROBLEMEVE TË PLANIT RREGULLUES URBAN TË LAGJES TUAJ

Sqarim: ky pyetësor ka për qëllim të identifikojë problemet rreth përmbajtjes së Planit Rregullues Urban të lagjeve Mati 1, Arbëria, Tophane, Prishtina e Re (zona perëndim), Qendra 1 dhe . Të dhënat nga pyetësori do t'i shërbejnë komunës për identifikimin e problemeve në implementimin e planeve rregulluese në këto lagje.

1. Cili PRRU e përfshin lagjen tuaj:

- a. Mati 1
- b. Arbëria
- c. Tophane
- d. Qendra 1he 2
- e. Prishtina e Re – zona perëndim

2. Kë e përfaqësoni ju?

Kompani: (emri/lloji) _____
Organizatë: (emri/lloji) _____
Përfaqësues i lagjes:(lokacioni) _____
Banor i lagjes: (emri/mbiemri) _____
Adresa juaj: _____

3. A jeni ne dijeni qe lagja juaj ka Plan Rregullues Urban?

- Kurrë s'kam dëgjuar për të
- Kam dëgjuar diçka ne lidhje me të
- Po, jam i njoftuar me të
- Nuk jam i sigurtë

4. A keni qene te informuar gjate fazës se hartimit te PRrU?

- a. PO
 b. JO

Nëse PO:

5. A janë marre parasysh kërkesat tuaja gjate hartimit?

- a. PO
b. JO

6. Sa jeni në dijeni për përmbajtjen e PRru së lagjes suaj?

- Pak
 Shumë pak
 Shumë
 Aspak

7. Cili problem është në lagjen tuaj sa i përket zbatimit të PRrU? (jepni një përshkrim të thjeshtë)

8. Pse është ky problem? Çfarë rezultati do të kishte nëse do të ishte zgjidhur?

9. I kujt është ky problem? Kush e ka atë?

10. Kujt do t'i interesonte zgjidhja e tij? (jepni emra individësh, organizatash që do duhej të kontribuonin në zgjidhjen e tij?)

11. Ku është ky problem?

Në të gjithë lagjen

Në një pjesë të lagjes

12. Sa kohë ka si problem? Kur paraqitet: në një orë specifike, konstant apo tjetër? _____

13. Çfarë do të ndodh nëse nuk bëhet asgjë për zgjidhjen e këtij problem?

14. Cilat projekte te PRru-se kane ndikuar ne jetën tuaj:

- Qasja në shërbime dhe dyqane
 Hapësirat e përbashkëta publike dhe parqet
 Rrugët
 Qasja ne transportin publik
 Mundësitë për punësim
 Kushtet e banimit
 Hapësirat e përbashkëta publike dhe parqet
 Hapësirat sportive

15. A keni ju apo banorët e lagjes tuaj interes të merrni pjesë në projektet që do të zhvillohen nga zbatimi I PRrU I lagjes tuaj?

Po _____ Jo _____

16. A keni kontribuar ju, banorët tjerë të lagjes më përpara në investime që ndërlidhen me zbatimin e PRrU të lagjes tuaj?

Po _____ Jo _____

Nëse po, shpjegoni me çfarë lloj resursesh keni kontribuar dhe për cka lloj projekti (p.sh investime në rregullimin e rrjetit të kanalizimit, rrugës...)

- Para _____
 Mjete pune (çfarë lloji) _____
 Tokë (sa ari/ha) _____
 Resurse njerëzore _____
 Tjera _____

17. A mundeni ju të kontribuoni në përmirësimin e kushteve të jetesës në lagjen tuaj? (rretho përgjigjen)

Po _____ Jo _____

Nëse po, shpjegoni me çfarë lloj resursesh mund të kontribuoni:

- Para _____
Mjete pune (çfarë lloji) _____
Tokë (sa ari/ha) _____
Resurse njerëzore _____
Tjera _____

18. Nëse jeni përgjegjur me “po” në pyetjen e 16, a mund të tregoni se në cilën lëmi jeni të interesuar të kontribuoni:

Banim _____
Arsim/edukim (specifiko) _____
Shëndetësi _____
Kulturë _____
Sport e rekreacion _____
Rregullim të hapësirave publike-sheshe, parqe, shëtitore _____

Mbrojtje të mjedisit

a) Gjelbërim _____
b) Aktivitete vetëdijesimi _____
c) Grumbullim/largim të mbeturinave _____
d) Menaxhim të fatkeqësive natyrore
(rregullimin e shtratit të lumenjve /përroskave) _____

Infrastrukturë dhe transport

a) Rrugë _____
b) Parkingje _____
c) Trotuare _____
d) Shtigje biçikletash _____
e) Rrjet të ujësjellësit _____
f) Rrjet të kanalizimit _____
g) Infrastrukturë IT/telekomunikimit _____
h) Transport publik _____

Trashëgimi kulturore (specifiko) _____

Aktivitete të zhvillimit ekonomik

a) Biznesore _____
b) Turizëm/hotelieri _____
c) Bujqësi/blegtori _____
d) Industri (specifiko llojin) _____
e) Ndërtimtari _____
f) Zejtari/artizanate _____
g) Tjera (specifiko) _____

Aktivitete të shoqërisë civile/komunitetit (specifiko) _____

Tjera (ju lutem specifikoni) _____

19. Nëse jeni përgjegjur me “po” në pyetjen e 16, a mund të shpjegoni se në çfarë kushtesh/parakushtesh jeni të interesuar dhe keni vullnetin të kontribuoni në përmirësimin e kushteve të jetesës në lagjen tuaj? (Ofroni aq përgjigje sa i shihni të rëndësishme)

- Nuk kam parakushte;
- Do të kontribuoj vetëm nëse komuna mbulon pjesën më të madhe të shpenzimeve;
- Do të kontribuoj vetëm nëse investimet e mia/tonat vlerësohen/tregohen publikisht;
- Do të kontribuoj vetëm atëherë kur edhe të tjerët do të kontribuojnë;
- Do të kontribuoj atëherë nëse në afat të shkurtër do të kem ndonjë përfitim direkt;
- Do të kontribuoj atëherë kur të shoh përfitime afatgjata;
- Do të kontribuoj atëherë kur.....(shpjegoni edhe kushte tjera që mund të mos jenë përmendur më lart)

ANEKSI 3:

INTERVISTIMI

Është metoda më e thjeshtë dhe e shpejtë e marrjes së mendimeve nga qytetarët dhe për mbledhjen e të dhënave. Në kontekstin e zhvillimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, në fazën e planifikimit intervistimi përdoret kur nevojitet mbledhja e të dhënave sidomos për pjesën e profilit dhe vlerësimit të gjendjes. Është metodë e përdorshme në veçanti në fazën e vlerësimit të zbatimit të planeve sepse intervistat ofrojnë informacion të detajuar.

Përparësitë dhe mangësitë e intervistimit janë:

Përparësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> Mund të bëhet menjëherë duke përdorur resurset njerëzore ekzistuese; Mund të bëhet sy-më-sy ose me telefon, varësisht nga numri i të intervistave të nevojshme dhe koha e nevojshme; Janë fleksibile dhe nuk limitohen në pyetjet e vendosura gjë që i mundëson intervistuesit të kuptojë më mirë pikëpamjet dhe opinio-net nga qytetarët; Mundëson vlerësimin e fuqisë së pikëpamjeve të palëve të interesit (që është gjithmonë një informatë e vlefshme); Kërkon pak trajnim ose përgatitje përveç të kuptuarit të fushëveprimitarisë dhe kontekstit të saj si dhe aftësisë për të zhvilluar intervista efektive. 	<ul style="list-style-type: none"> Mund të marrin mjaft kohë, sidomos intervistat sy-më-sy; Nuk mund të gjenerojnë rezultate kuantitative, p.sh. për dallim nga anketimi; Mund të japin rezultate të ndryshme për intervistues të ndryshëm për shkak të stilit personal, aftësia për të kujtuar detajet dhe dallimeve në mes individëve.
<i>Burimi: Citizens participation in decision making (Research Triangle Institute International)</i>	

Zakonisht intervistimi bëhet një-për-një, por mund të jetë edhe intervistim në grup. Njëri ndër hapat e parë në intervistim është gjetja e informatorëve që kanë njohuri dhe janë në gjendje të japin informata përkatëse. Tipet e intervistave janë:

Tipet e intervistave	Karakteristikat
Intervistat joformale në formë bisede	Pyetjet dalin nga konteksti i menjëhershëm dhe janë pyetje në rrjedhën e natyrshme të gjërave. Pyetjet, tema ose formulimi nuk janë të paracaktuara;
Intervistë me qasje drejtuese	Temat dhe çështjet që do të mbulohen janë të specifikuar paraprakisht, në formë përshkruese. Intervistuesi vendos renditjen dhe formulimin e pyetjeve në rrjedhën e intervistës;
Intervistë standarde me pyetje hapura	Formulimi i saktë dhe sekuenca e pyetjeve përcaktohen paraprakisht. Të gjithë të intervistuarve ju bëhen të njëjtat pyetje dhe me radhitjen e njëjtë. Pyetjet janë formuluar në një formë të pakufizuar (pyetje të hapura);
Intervistë me përgjigje të mbyllura	Pyetjet dhe kategoria e përgjigjeve janë të paracaktuara. Të intervistuarit zgjedhin nga radhët e përgjigjeve fikse.

Këshilla praktike për intervistime efektive:

- Sigurohuni që e keni të definuar qartë qëllimin e intervistës dhe që intervistuesit e kanë kuptuar atë mirë, në mënyrë që të intervistuarit ta kenë të qartë.
- Një element bazik i intervistës, të cilën intervistuesi duhet ta dijë është ai i kohëzgjatjes. Parimisht një intervistë nuk duhet të jetë më e shkurtër se 30 minuta.
- Gjithashtu shpjegoni se për çka do të përdoret informata nga intervista dhe tipet e njerëzve që janë duke u intervistuar.
- Mundohuni të tregoni sa më shumë respekt për të intervistuarit gjatë intervistës – ata do të ndihen të kënaqur pasi që pikëpamjet e tyre po konsiderohen të rëndësishme.
- Intervistuesi duhet të krijojë atmosferë të rehatshme dhe relaksuese gjatë procesit – ai/ajo nuk duhet të jetë i/e frikësuar gjatë intervistimit, dhe sensi i humorit konsiderohet aset.
- Shmangni pyetjet e mbyllura të cilat kanë opsion përgjigje me PO/JO; pyetjet e hapura (pa orinetim ose alternativa të përgjigjeve) janë më gjithëpërfshirëse; mos i manipuloni të intervistuarit.
- Intervistuesi duhet të përgatisë një raport përmbledhës nga intervista sa më parë që është e mundur, pasi të kenë përfunduar sesionet dhe të bazojë raportet në shënimet e marra gjatë intervistës ose të i incizojë ato (duhet të kërkohet leje para secilës intervistë). Preferohet të shkruhet raporti i një interviste para se

ANEKSI 4 :

FOKUS GRUPET

të kalohet tek tjetra, në mënyre që materiali të jetë i freskët dhe i qartë, si dhe raportimi të jetë i saktë.

- h) Siguroni konfidencialitetin e intervistës. Mos përdorni emra nëse i intervistuari kërkon ashtu. Nëse përmbledhja e intervistës shpërndahet publikisht, sigurohuni të mbroni konfidencialitetin e individëve të intervistuar.

Çka janë fokus-grupet

Fokus grupet janë një metodë efektive e mbledhjes së të dhënave kualitative për të kuptuar më mirë gamën e këndvështrimeve që ekzistojnë brenda një komuniteti ose një grupi të komunitetit. Ato mundësojnë një diskutim të thelluar lidhur me ndonjë çështje apo temë të përcaktuar qartë. Meqenëse pjesëmarrësit në këto grupe dallojnë për nga mosha, gjinia, edukimi dhe gjendja socio-ekonomike etj, është e pritshme që edhe këndvështrimet e tyre do të jenë të ndryshme. Në këtë mënyrë, gjatë procesit të planifikimit, fokus grupet ndihmojnë në krijimin e një pasqyre të kompletuar se si çështjet e caktuara ndikojnë në komunitet.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve

Zakonisht përzgjedhja e mostrës përfaqësuese të pjesëmarrësve bëhet varësisht nga çështja e cila trajtohet dhe kontributi i mundshëm i pjesëmarrësve. Ose, pjesëmarrësit mund të përzgjidhen rastësisht nga një grup më i madh i komunitetit, duke patur parasysh aftësitë e tyre për të dhënë njohuri për çështjen e cila trajtohet.

Gjatë themelimit të fokus grupit është e rëndësishme të sigurohemi se përbërja e tij e reflekton popullatën e synuar në aspektin e gjinisë, përkatësisë etnike, fesë, pikëpamjeve politike, statusit social-ekonomik, moshës, edukimit, dhe çfarëdo aspekti tjetër që mund të jetë i rëndësishëm. Gjithashtu është më rëndësi që personat e përzgjedhur të kenë interesim për pjesëmarrje. Identifikimi i tyre mund të arrihet përmes konsultimit dhe referencave nga kontakt - personat lokal të cilët kanë lidhje me grupet e ndryshme të komunitetit.

Nëse është e mundur, pjesëmarrësit e fokus grupit duhet të kompensohen për angazhimin e tyre. Në rast se kjo nuk është e mundur, në secilin rast duhet siguruar kompensimi për shpenzimet e udhëtimit, qasja për personat me përvojë të veçanta, pije dhe ushqim të lehtë gjatë sesioneve punuese. Një atmosferë e relaksuar e punës inkurajon pjesëmarrësit të flasin dhe promovon një diskutim të hapur, dy faktorë me rëndësi jetike për një fokus grup të suksesshëm.

Struktura e fokus-grupit

Nuk ka ndonjë rregull strikte për atë se cili është numri i duhur i anëtarëve të fokus-grupit. Zakonisht, preferohet që numri i anëtarëve të jetë nga 6 -12 persona. Duhet patur parasysh që përkundër nevojës që të kemi më shumë njerëz për një diskutim sa më të gjallë, shpesh numri i madh i pjesëmarrësve e pamundëson menaxhimin

me sukses të punës në grup. Prandaj, këto dy aspekte duhet të balansohen me kujdes, në mënyrë që të arrihen e rezultatet e pritura nga puna e fokus-grupit.

Ajo që ka më shumë rëndësi është përcaktimi i numrit të fokus-grupeve të nevojshme në mënyrë që të mbulohet nevoja për informacionet e nevojshme gjatë procesit të planifikimit. Kjo vlerësohet në vazhdimësi nga autoriteti përgjegjës për planifikim hapësinor i cili i themelon fokus-grupet për temat përkatëse.

Takimet e fokus-grupit

Sesionet punuese të fokus-grupeve preferohet të mos zgjasin më tepër se dy orë, përfshirë edhe kohën për pauza të shkurtëra. Koha e përcaktuar duhet të respektohet dhe në pajtim me këtë duhet bërë edhe mbulimit i pyetjeve të nevojshme për diskutim.

Moderatori i takimit është përgjegjës për mbarvajtjen e diskutimit dhe perqëndrimin në temën e caktuar. Prandaj, roli i moderatorit është thelbësor për punë të suksesshme të fokus-grupit. Një moderator i mirë duhet të ketë shkathtësi që të drejtojë diskutimin në të cilin ai inkuadrohet shumë pak duke e bërë të qartë për pjesëmarrësit se është kontributi i tyre në proces ai që vlerësohet. Moderatorin nuk duhet të shpreh opinionet e tij për çështjen për të cilën diskutohet dhe duhet të bëjë pyetje shtesë për të nxitur përgjigje nga pjesëmarrësit.

Menaxhimi i diskutimit

Moderimi i diskutimit në takimet e fokus - grupit kërkon shkathtësi të caktuara. Prandaj, moderatorin duhet të jetë fleksibil, i aftë që të përcjellë rrjedhën e diskutimit dhe të reagojë në kohën dhe mënyrën e duhur.

- Pas prezantimit të pjesëmarrësve dhe qëllimit të përgjithshëm të fokus grupit, bëhen pyetje të përgjithshme të cilat kanë për qëllim kyçje e pjesëmarrësve në diskutim. Pjesëmarrësve u bëhet e qartë se nuk ka përgjigje të drejta as të gabuara dhe se është në rregull nëse ka mospajtueshmëri me përgjigjet e të tjerëve.
- Pyetjet duhet të jenë të hapura, në mënyrë që të ofrojnë mundësi për përgjigje të gjatë dhe shpjeguese. Nga pjesëmarrësit kërkohet të shprehin qëndrimet , ndjenjat dhe përvojat e tyre.
- Moderatorin duhet të jetë i kujdesshëm që i tërë grupi të përfshihet në diskutim.
- Pjesëmarrësve duhet të ju ofrohet koha e nevojshme për të menduar rreth pyetjeve të ngritura.
- Diskutimi duhet të zhvillohet me ndërhyrje minimale nga ana e moderatorit. Nuk duhet dhënë komente ose këshilla në kontributet e pjesëmarrësve. Roli i moderatorit është të mbledhë informata e jo ti ofron ato.

- Caktimi i disa rregullave bazë të komunikimit brenda grupit (respekti i ndërsjellë, mundësia e secilit për tu shprehur, pranimi i mendimit të tjerëve, etj.) ofrojnë mundësi për shmangien e situatave dhe sjelljeve të padëshirueshme si dominimi i diskutimit, shprehja e qëndrimeve negative ose shpërthimeve emocionale të cilat janë të papranueshme. Nga moderatorin kërkohet që në raste të tilla të drejtojë diskutimin në drejtim produktiv duke intervenuar me qetësi dhe dialog.
- Është shumë e rëndësishme që përveç moderatorit edhe asistenti i tij të mbajë shënime të hollësishme gjatë takimit. Duhet të regjistrohen edhe sjelljet dhe reagimet joverbale të pjesëmarrësve dhe çdo gjë që mund ti ndihmojë moderatorin në interpretimin sa më të mirë të deklaratave të pjesëmarrësve.
- Me afrimin e kohës për përfundimin e takimit, moderatorin duhet të fillon përmbylljen e sesionit duke e bërë një përmbledhje të diskutimit për tu siguruar se çfarë kanë deklaruar pjesëmarrësit dhe si të bëhet interpretimi i tyre. Me një shqyrtim të shpejtë të komenteve nga takimi bëhet një listë e temave kryesore të përbashkëta që jep indikacione se çka është më e rëndësishme për pjesëmarrësit.

Në fund, moderatorin duhet të falënderojë pjesëmarrësit për kontributin e tyre duke i siguruar ata se deklaratat e tyre do të mbesin konfidenciale.

ANEKSI 5:

FORMULAR VLERËSIMI

“PUNËTORIA.....”

Data

Vendi

1. **NË ÇFARË MASE MENDONI SE JANË ARRITUR QËLLIMET E CEKURA TË PUNËTORISË?**

Qëllimi 1: Krijimi i mundësisë që shoqëria civile, komuniteti i biznesit dhe tjerët të përfshihen në planifikimin hapësinor dhe shoqëror me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës.

Qëllimi 2: Përforcimi i dialogut dhe bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit me autoritetet lokale.

Qëllimi 3: Ngritja e vetëdijes së shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, qytetarëve dhe të tjerëve për të drejtën e pronësisë ndaj Planit Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës, etj....

Qëllimi 4....

- Shumë të madhe
- Të madhe
- Mesatare
- Të vogël
- Aspak

2. **NË ÇFARË MASE JANË TË DOBISHME PËR PUNËN TUAJ TË PËRDITSHME INFORMACIONET E MARRA GJATË PUNËTORISË? ?**

- Shumë të madhe
- Të madhe
- Mesatare
- Të vogël
- Aspak

3. **CILA PJESË E PUNËTORISË JU KA PËLQYER MË SHUMË? MUND TË PËRSGJIGJENI NË MË SHUMË OPCIONE**

- Sesioni 1
- Sesioni 2
- Sesioni 3

4. **SA JENI TË KËNAQUR ME NIVELIN E ORGANIZIMIT DHE METODOLOGJINË E PUNËTORISË?**

- Shumë të kënaqur
- Të kënaqur
- Mesatarisht të kënaqur
- Mjaftueshëm
- Aspak

5. **SI E KONSIDERONI AGJENDEN E PUNËTORISË?**

- Shumë të ngarkuar
- Të ngarkuar
- Adekuate
- Shumë të lehtë

6. **KOMENTET APO SUGJERIMET E JUAJA SHITESË SE SI MUND TË PËRMIRËSOHEJ KJO PUNËTORI NË TË ARDHMEN?**

Referencat:

MMPH, Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174, 2013

MMPH, Ligji për planifikim hapësinor,UA Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor

Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit (2011): “Udhëzues për procesin e konsultimeve publike”

Arnstein, S. R. (1969): A ladder of citizen participation. Journal of The American Institute of Planners, 35, pp. 216–224.

UN-Habitat (2007), Inclusive and sustainable urban planning: A guide for municipalities

Lefevre, Pierre; Kolsteren, Patrick; De Wael, Marie-Paule; Byekwaso, Francis; Beghin, Ivan (December 2000). “Comprehensive Participatory Planning and Evaluation”